



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI JURIDIK

ПРАВЕH ФАКУЛТЕТ

LAW FACULTY

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

PROGRAMI- E DREJTA PENALE

TEMA

“Veprat penale kundër njerëzimit aspektet nacionale dhe
ndërkombëtare”

MENTORI:

Prof.dr.Ismail ZEJNELI

KANDIDATI:

Birsen JONUZI

Tetovë, 2020

*“Leaders who are silent and do nothing are as guilty and do worse than those who commit these
horrific attacks”*

— **George Stamatis**

DEKLARATË

Unë *Birsen Jonuzi* me përgjegjësi të plotë deklaroj se jam autor origjinal i këtij desertacioni dhe puna e raportuar këtu ka përbërje tërësisht origjinale. Informacini i marrë nga puna e botuar ose e pabotuar e të tjerëve është e cituar në tekst dhe referencat janë dhënë në listën e burimeve .

Tetovë , 2020

.....

PËRMBAJTJA E PUNIMIT

DEKLARATË.....	3
HYRJE	6
Qëllimet e hulumtimit.....	7
Metodologjia e hulumtimit	8
Rëndësia e punimit.....	9
KAPITULLI I 1	10
1.1 Nocioni i veprave penale kundër njerëzimit	10
1.2 Aspekte historike të veprave penale kundër njerëzimit	12
1.3 Definicioni i krimit të luftës.....	19
1.3.1 Ekspertiza në procedura gjyqësore që përfshijnë krime të luftës.....	20
1.4 Menaxhimi me barrën e lëndëve të krimeve të luftës	21
1.5 Informimi i publikut lidhur me trajtimin e rasteve të krimeve të luftës.....	23
KAPITULLI I 2	24
2.1 Krimet kundërnjerëzimit sipas Kodit Penal në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	24
2.2.1 Gjenocidi.....	25
2.2.2 Krimet kundër njerëzimit.....	26
2.2.3 Krimet kundër agresionit	26
2.3 Krimet kundër populates civile.....	27
2.4 Krimet kundër rrobërve të luftës.....	29
2.5 Përdorimi i mjeteve të pajeluaja të luftës	29
2.6 Lejimi apo arsyetimi i gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit ose krimeve të luftës.....	30
2.7 Keqpërdorimi i armës kimike apo biologjike.....	30
2.8 Përgjegjësia e komandantëve dhe eproreve	30
3.1 Konventat ndërkombëtare.....	31

3.2 Konventat ndërkombëtare të miratuara nga OKB	36
3.3 Konventat e miratuara nga vendet e Bashkimit Europian	38
3.4 Konventa për mos parashkrimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit	40
3.5 Konventa për parandalimin dhe dënimin e Gjenocidit.....	41
4.1 Raste nga praktika lidhur me veprat penale kundër njerëzimit.....	42
4.2 Historiku i konfliktit në Kosovë 1998-1999	49
4.2.1 Statistikat.....	52
4.2.2 Aktakuzat ndaj Udhëheqësve Serb (Kosovë, Kroaci, Bosnj dhe Hercegovinë)	54
a) Slobodan Milosevic	54
b) Kosovë.....	54
4.2.3 Masakra e Reçakut.....	55
4.2.4 Masakra e Deçanit.....	57
c) Kroaci	61
d) Bosnja dhe Hercegovina	61
4.3 Historiku i gjenocidit ndaj Muslimanve Bosnjak 1683-1699.....	62
4.3.1 Gjenocidi i dytë ndaj Muslimanëve “shfarosje e turkoshakëve”1711	63
4.3.2 Gjenocidi i tretë ndaj Muslimanëve “shfarosje e përgjithshme e turqëve-muslimanëve nga populli” 1804-1820	64
4.3.3 Gjenocidi i Srebrenicës 1995	64
PËRFUNDIMI	66
Bibliografia	69
I -Libra	69
II- Burime tjera	70
Web – Faqe	73
III- Ligje, Kushtetuta	74

HYRJE

Pavarësisht nga fakti se një vepër është e dënueshme penalisht, rrezikshmëria e saj nuk është e njëjtë, rrethanat në të cilat kryhet ajo ndryshojnë dhe faktorët që ndikojnë mbi autorin e saj variojnë. E drejta e jetës është një ndër të drejtat dhe liritë themelore të njeriut e cila sanksionuar dhe e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Krimet kundër njerëzimit përbëjnë një nga format më ekstreme të shkeljes së drejtave të njeriut. Një vepër penale e re por me një dinamik të veçantë përta i përket subjektit që mbrohet. Qëllimi që ndërmora këtë punim qëndron në faktin se vepra penale e krimeve kundër njerëzimit është relativisht vepër e re e jurisprudencës penale dhe aktualisht në Maqedoninë e Veriut nuk ka punime ose artikuj të mirëfilltë që e trajtojnë më gjerësisht se ajo që trajtohet në Të drejtën Penale Ndërkombëtare, të autores Jola Xhafo. Ky punim synon të jetë një kontribut në fushën e së drejtës penale ndërkombëtare në Maqedoninë e Veriut sepse mund të shërbejë në plotësimin dhe ndryshimin e mangësive ligjore sipas Statuti të Romës, si dhe mund të shërbejë plotësim në jurisprudencën e të drejtës ndërkombëtare penale shqiptare duke sjellur risitë e reja krahasuese.

Qëllimet e hulumtimit

Punimi mendohet të ketë një rëndësi të veçantë shkaku se përveç problemeve dhe sfidave që ky punim synon të jetë një kontribut në fushën e së drejtës penale ndërkombëtare në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë sepse mund të shërbejë në plotësimin dhe ndryshimin e mangësive ligjore sipas Statuti të Romës, si dhe mund të shërbejë plotësim në jurisprudencën e të drejtës ndërkombëtare penale duke sjellur risitë e reja krahasuese. Ky punim ndahet në 5 kapituj, ku do të analizohen format që përbëjnë krime kundër njerëzimit, si u bë e njohur kjo vepër dhe nga mori shkas, si dhe si parashikohet në legjislacionin në kodin tonë, statutet ndërkombëtare dhe në legjislacionet e shteteve europiane. Pyetjet kërkimore që synohet t'i japim përgjigje është: ‘ Sa është në përputhje vepra penale e krimeve kundër njerëzimit në legjislacionin francez, gjerman, italian, kosovar dhe polak me legjislacionin shqiptarë.

Qëllimi i këtij punimi është pikërisht krimet kundër njerëzimit të cilat janë një ndër veprat penale dhe një ndër sfidat më të mëdha në shekullin 19 dhe 20. Që nga Lufta e I Botërore deri në Tribunalin për Krimet e Ish-Jugosllavisë, kjo vepër ka pësuar shumë qasje të reja, por themeli i saj ka qënë po i njëjtë. Kjo vepër penale dënohet pothuajse në të gjitha legjislacionet ndërkombëtare. Kjo tregon për rëndësinë që ka moslejueshmëria për ndodhjen e akteve të tilla. Nga historia jemi mësuar të dëgjojmë për format makabre të marrjes së jetës, përdhunimeve, deportimeve etj që janë ndërmarrë ndaj popullsisë civile. Përmendim këtu dy më të rëndat, holokhaustin dhe luftën në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë. Për parandalimin e saj janë ndërmarrë shumë konventa, statute, protokolle, përmendim këtu statutet e tribunaleve për krimet ndërkombëtare, Statutin e Romës, Konventa e Gjenevës etj.

Metodologjia e hulumtimit

Në këtë punim studimor do të shfrytëzohet një metodologji e tillë hulumtimi që nisët nga e përgjithshmja tek konkretja. Në radhë të parë jepen objektivat e përgjithshme dhe specifike se ç'farë pretendohet të arrihet në këtë studim, metodat dhe teknikat që do të përdoren, të dhënat e përgjithshme dhe specifike të këtij studimi, analiza e tyre si dhe në fund interpretimi i rezultateve.

Rezultatet e gjetura nuk kanë për qëllim përgjithësimi. Në këtë punim do të analizojmë legjislacionet vendore dhe ndërkombëtare që flasin rreth veprave penale kundër njerëzimit. Do të përdoren Metodatat statistikore-përmes tabelave dhe grafikoneve do të jepen të dhëna relevante sasimore për gjendjen e veprave penale kundër njerëzimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Metodologjia e përdorur është ajo krahasuese siç përmenda edhe më lartë. Metodatat që janë përdorur përmendim metodën cilësore, analizuese, ku do të trajtohen format e krimit dhe sanksionet përkatëse, format e implementimit dhe sesi ka evoluar ky krim.

Rëndësia e punimit

Ky hulumtim shkencor ka rëndësi të madhe në vendin dhe kushtet të cilat në jetojmë sot. Ky punim do jetë një kontribut me interes timin që të marr gradën magjistre e diplomuar dhe audiencën të cilën do ta lexojnë në vazhdim që të njihen edhe më së shumti rreth krimeve kundër njerëzimit në vendin tonë dhe rajon. Po ashtu ky punim është i rëndësishëm se hollë-hollë do të analizohen rekomandimet për Republikën e Maqedonisë së Veriut rreth mangësive ligjore dhe doktrinale si dhe përafrimin e legjislacionit të brendshëm me Statutin e Romës.

KAPITULLI I 1

1.1 Nocioni i veprave penale kundër njerëzimit

Nocioni “*vepër penale*” (“criminal offence” në versionin anglisht) ka një kuptim autonom, njëlloj si “*lëmi penal*” i nenit 6 të Konventës.¹ Krimet kundër njerëzimit përbëjnë një nga sfidat më të mëdha të shekujve XX dhe XXI. Që nga Lufta e I Botërore deri në Tribunalin për Krimet e Ish-Jugosllavisë, kjo vepër ka pësuar shumë qasje të reja, por themeli i saj ka qënë po i njëjtë. Kjo vepër penale dënohet pothuajse në të gjitha legjislacionet ndërkombëtare. Kjo tregon për rëndësinë që ka moslejueshmëria për ndodhjen e akteve të tilla. Nga historia jemi mësuar të dëgjojmë për format makabre të marrjes së jetës, përdhunimeve, deportimeve etj që janë ndërmarrë ndaj popullsisë civile.² Me “*vepra penale kundër personit*”³ do të kuptojmë të gjithë ato vepra (veprime apo mosveprime) shoqërisht të rrezikshme dhe të kundërligjshme, që kryhen me dashje ose nga pakujdesia dhe që cenojnë jetën, integritetin fizik/psikik, lirinë personale, lirinë seksuale, nderin dhe dinjitetin e njeriut, të mbrojtura në mënyrë të posaçme nga Kodi Penal. Në këtë prizëm, përballë çdo të drejte që gëzon personi njerëzor qëndron një detyrim i shtetit demokratik dhe organeve shtetërore/mekanismave të tij për garantimin e kësaj të drejte. Për shembull, përballë të drejtës për jetën qëndron detyrimi i shtetit për mbrojtjen e jetës, përballë të drejtës për liri dhe siguri qëndron detyrimi i shtetit për mbrojtjen e lirisë dhe të sigurisë personale, përballë ndalimit të torturës qëndron detyrimi i shtetit për marrjen e të gjithë masave për të siguruar ndalimin e ushtrimit të torturës nga ana e organeve shtetërore, dhe kështu me radhë për çdo të drejtë dhe liri tjetër, që çdokush i gëzon në sajë të ekzistencës së tij si qenie njerëzore, pavarësisht racës, gjuhës, prejardhjes apo gjinisë.⁴

Pra, një detyrim po aq i rëndësishëm sa edhe vetë këto të drejta themelore është detyrimi i shtetit që të garantojë mbrojtjen juridiko-penale të personit njerëzor me anë të të gjithë mekanizmave dhe organeve shtetërore të tij.

¹ Për fushën e zbatimit të nenit 6 (pjesa penale) dhe nocionin “akuzë në lëmin penal”, shih faqet 7 deri 11 të Udhëzues rreth nenit 6 (pjesa penale), i disponueshëm në adresën e Gjykatës në internet (www.echr.coe.int – Case-law).

² Von Bar, L., A history of continental criminal law, Boston. 1999, f. 67

³ Elezi, Ismet. E drejta penale: pjesa e Posaçme: azhurnuar e plotësuar me shtesat e ndryshimet e bëra me reformat ligjore të viteve 2001-2013. Tiranë: Kumi, 2014.

⁴ Po aty.

Nëpërmjet krijimit të një sistemi efektiv dhe parandalues të së drejtës penale, shtetet janë të detyruara që nëpërmjet organeve dhe agjencive të tyre ligjzbatuese të ndjekin penalisht çdo sjellje të kundërligjshme kundër personit të parashikuar në legjislacionin penal dhe që sjell si pasojë mohimin ose cenimin e të drejtave dhe lirive themelore të tij. Mbrojtja e të drejtës për jetën dhe të drejtave të tjera që kanë të bëjnë me shëndetin, lirinë personale, lirinë seksuale, nderin dhe dinjitetin njerëzor sanksionohen në Kodin Penal të çdo shteti, duke parashikuar veprat penale të drejtuara kundër personit dhe dënimet përkatëse ndaj autorëve të kryerjes së veprave të tilla. Në këtë kontekst, mund të themi se Kodi Penal luan një rol të rëndësishëm ndëshkues, parandalues dhe edukues nëpërmjet parashikimit të veprave penale nga ligji penal dhe të dënimeve përkatëse kundër autorëve të tyre.⁵

Në aktualitetin e temës, veprat penale kundër personit nuk janë thjesht një çështje teoriko-juridike, por ato përbëjnë edhe një problematikë shqetësuese konstante për shoqërinë njerëzore, duke qenë se numri dhe gjeografia e përhapjes së tyre shënon një rritje shqetësuese. Në nivel të legjislacionit kombëtar, mbrojtja e personit njerëzor sigurohet në mënyrë më të plotë edhe nëpërmjet ligjeve apo akteve ligjore të tjera në fushën e shëndetësisë dhe të mjekësisë. Në këtë kuptim, mbrojtja e personit njerëzor sigurohet në mënyra, forma dhe mjete të ndryshme parandaluese dhe ligjore, jo vetëm në nivel kushtetues, konvencional dhe të legjislacionit penal, por gjithashtu në nivel të ligjeve të ndryshme për shëndetin. Në përfundim, për sa më sipër, arrijmë në konkluzionin se, nga shkalla e mbrojtjes së personit njerëzor përcaktohet drejtpërdrejt edhe vetë pozita e individit në shoqëri, duke krijuar dhe zhvilluar në këtë mënyrë mundësitë e kushtet për realizimin e të drejtave dhe lirive themelore të tij. Për këtë qëllim, mbrojtja juridiko-penale e personit njerëzor luan një rol thelbësor në funksion të respektimit dhe të garantimit të këtyre të drejtave dhe të lirive themelore.⁶

Veprat penale kundër personit njerëzor klasifikohen: në krime kundër jetës, në vepra penale kundër shëndetit, në vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë, në krime seksuale dhe në vepra penale kundër lirisë së personit.⁷ Ky klasifikim është relativ pasi në kreun II të veprave penale kundër personit gjenden të grupuara në seksione të veçanta edhe dy kategori të tjera veprash penale si: veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes dhe

⁵ Elezi, Ismet. E drejta penale: pjesa e Posaçme: azhornuar e plotësuar me shtesat e ndryshimet e bëra me reformat ligjore të viteve 2001-2013. Tiranë: Kumi, 2014.

⁶ Po aty

⁷ 6 Elezi, I., E drejta penale (pjesa e posaçme), 2008, f. 33

veprat penale kundër lirisë së besimit. Duke qenë se të tilla vepra penale nuk kanë si objekt kryesor e të drejtpërdrejtë mbrojtjen e personit në kuptimin e tij të ngushtë, fokusi kryesor është përqendruar në klasifikimin e sipërpërmendur të veprave penale kundër personi⁸.

Me vepra penale kundër personit njerëzor kuptohen ato vepra (veprime ose mosveprime) të kundërligjshme, të kryera me dashje ose nga pakujdesia, të cilat prekin ose vënë në rrezik jetën, shëndetin, lirinë, paprekshmërinë seksuale, nderin e dinjitetin e personit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal.⁹ Si rrjedhim, duke shqyrtuar elementet përbërëse të veprave penale kundër personit arrijmë në konkluzionin se me objekt të përgjithshëm të veprave penale kundër personit njerëzor kuptojmë atë grup marrëdhëniesh juridikoshoqërore, të vendosura dhe të sanksionuara nga Kodi Penal për të garantuar mbrojtjen dhe paprekshmërinë e personit njerëzor (duke përfshirë këtu mbrojtjen e jetës, të shëndetit, nderit, dinjitetit dhe të të drejtave të tjera themelore të personit njerëzor). Nga ana objektive, këto kategori veprash penale realizohen me veprime ose mosveprime shoqërisht të rrezikshme e të kundërligjshme, ku dalin në pah elemente të tilla, si: mënyrat, mjetet apo koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale (lidhja shkak-pasojë). Subjekt i kryerjes së veprave penale kundër personit njerëzor është çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale sipas legjislacionit kombëtar dhe është i përgjegjshëm.

1.2 Aspekte historike të veprave penale kundër njerëzimit

*“Krimi gjithmonë është rezultat i interaksionit të kriminelit dhe rrethit në të cilin llogaritet edhe viktima, “sepse praktikisht nuk ka krim pa viktimë” dhe situatën specifike të deliktit”*¹⁰ Pra, nuk ka viktimë pa krim, për ç’arsye është edhe e pamundur edhe të flitet për teoritë e drejtësisë mbi viktimën pa një qasje ndaj teorisë mbi krimin. Shkenca e cila studion krimin është kriminologjia. Nocionin kriminologji së pari e ka përdorur P. Topinard (1879), kurse nga ai më pas e ka marrë R. Garofalo (1884), i cili i ka dalluar shkencat të cilat merren me studimin e veprave të kryera penale. Në fillim lëndë e studimit të kriminologjisë ka qenë “njeriu”, krimineli, ndërkaq më vonë përveç delinkuentëve studiohen edhe aktivitetet kriminale. Nëse analizojmë zhvillimin historik të

⁸ Elezi, I., E drejta penale (pjesa e posaçme), 2008, f. 33

⁹ Po aty

¹⁰ Zvonimir Šeparović, Vitimologija – studija o žrtvama, Informator, Zagreb, 2001, fq. 14.

mendimit kriminologjik dhe të kriminologjisë, atëherë domosdo duhet tu qasemi disa botëkuptimeve dominuese sidomos të atyre që kanë të bëjnë me: mendimin paraklasik dhe klasik mbi kriminalitetin, teorinë antropologjike, teorinë biologjike, teorinë psikopatologjike, teorinë psikologjike, teorinë sociologjike, të kuptuarit dhe kritikën marksiste mbi kriminalitetin apo kriminologjinë e re. Kur flasim për mendimin paraklasik dhe klasik mbi kriminalitetin, atëherë i kemi 4 periudha specifike siç janë: mendimi antik, periudha e mesjetës, shkrimtarët e renesancës dhe shkollën historike juridike dhe mendimin e shkollës klasike penale-juridike. Për zhvillimin e së drejtës së luftës më meritoret janë organizatat ndërkombëtare të karakterit universal: Liga e Kombeve (1920) dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara (1945). Pra me zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare publike, ka ardhur edhe deri te zhvillimi i së drejtë ndërkombëtare penale. *“Prandaj edhe mund të thuhet që edhe zhvillimi i këtyre dy fushave të së drejtës ndërkombëtare publike në një masë të madhe është zhvilluar paralelisht. Ky zhvillim në bazë të specifikave historike do të mund të ndahej në disa periudha kohore. Periudha e parë do t’i përkiste luftës së parë botërore, periudha e dytë midis dy luftërave botërore, kurse periudha e tretë pas luftës së dytë botërore, kurse për të katërtën do të mund të thuhet se ka filluar në kohën në të cilën po jetojmë, e kjo është dekada e fundit e shekullit XX”*¹¹

Krimet kundër njerëzimit u bënë të njohura fillimisht nga Deklarata E Forcave Aleate (Rusia, Franca dhe Britania).¹² Në këtë deklaratë këto shtete i quajtën krime kundër njerëzimit, veprimet e Perandorisë Osmane kundër popullsisë armene në muajin prill 1915, ku si pasojë humbën jetën 1,5 milion njerëz. Për këto krime nuk pati të dënuar pasi Porta e Lartë nuk e pranoi krimin. Pas Luftës së Dytë Botërore holokhausti ndaj hebrenjëve çoj në domosdoshmërinë e ndëshkimit të kriminelëve të luftës. Si pasojë e Luftës së Dytë Botërore, shtetet fituese themeluan Kartën Ndërkombëtare të Tribunaleve Ushtarakë, më 8 maj 1945. Qëllimi i tribunalit ishte të dënonte përgjegjësit ushtarakë që akuzoheshin për krime lufte. Në këtë Kartë përfshihej dhe krijimi i Tribunalit të Nurembergut.¹³ Hartuesit e kësaj Karte u përballën me problemin se në krimet e luftës nuk përfshihej vrasja e qytetarëve nga vetë shteti i tyre. Nga vetë veprimet ç’njerëzore të

¹¹ Zvonimir Tomić, Nirnberška presuda, Sarajevo: Magistrat, 2001, fq.11.

¹² Zyra E Punëve të Jashtme Francë 24 Maj 1915, Deklarata për dënueshmërinë e akteve të ndërmarrë nga Porta E Lartë në Armeni.

¹³ Neni 22 i Kartës Ndërkombëtare të Tribunaleve Ushtarakë

ndërmarra nga viti 1939-1945 nga ushtria naziste, këto akte morën emrin krime kundër njerëzimit. Përkatësisht¹⁴ :

“Krime kundër njerëzimit: vrasje, shfarosje, skllavërim, deportim, dhe akte të tjera çnjerëzore të kryera kundër popullsisë civile, para ose gjatë luftës; ose përndjekje mbi baza politike, racore ose fetare në ekzekutimin ose në lidhje me ndonjë krim brenda juridiksionit të Tribunalit, nëse janë ose jo në shkelje të ligjit të brendshëm të vendit ku kryhen”.

Sa i përket përgjegjësisë penale individuale, Karta parashikonte që udhëheqësit, organizatorët, nxitësit dhe bashkëpunëtorët, në formulimin ose ekzekutimin e një plani të përbashkët ose komploti për të kryer ndonjë nga krimet e parashikuara, janë përgjegjës për të gjitha veprimet e kryera nga persona të tjerë, që lidhen me ekzekutimin e një plani të tillë.¹⁵ Gjithashtu, bëri të qartë se pozita zyrtare e të pandehurve, nuk do të konsiderohet si përjashtim nga përgjegjësia penal ose lehtësi në dënim.¹⁶ Gjithashtu parashikohej që dhe një dëshmi përbënte prove.¹⁷ Vendimet e këtij tribunali ishin përfundimtare.¹⁸ Ky tribunal zgjati 284 ditë¹⁹ dhe u dënuan 22 persona, nga ku 11 me vdekje.

Krahas Tribunalit të Nurembergut, themelua në 29 prill 1946 nga Forcat Aleate dhe Tribunal i Tokios për të dënuar ushtarakët, politikanët dhe perandorin japonez për krimet e kryera nga forcat japoneze. Krime kundër njerëzimit sipas Kartës së Tokios përbënte²⁰:

“Vrasja, shfarosja, skllavërimi, deportimi, dhe veprime të tjera çnjerëzore të kryera kundër popullsisë civile, para ose gjatë luftës, ose përndjekja mbi baza politike apo racore në ekzekutimin ose në lidhje me ndonjë krim brenda juridiksionit të Tribunalit, nëse janë ose jo në shkelje të ligjit të brendshëm të vendit ku kryhen”.

Gjykimi u zhvillua nga 3 maji 1946 deri më 12 nëntor 1948. Megjithatë, Tribunal i Tokios konsiderohet më pak autoritar se ai i Tribunalit të Nurembergut, për shkak të, përfshirjes politikës në procesin e aktakuzës, mangësitë në gjykimin dhe paragjykimet e gjyqtarëve.²¹ Në një gjyq që zgjati gati dy vjet e gjysmë, 28 udhëheqës ushtarakë dhe politikë japonezë u dënuan, 7

¹⁴ Neni 6/c i Statutit të Nurembergut

¹⁵ Neni 6/1 i Statutit të Nurembergut

¹⁶ Neni 7 i Statutit të Nurembergut

¹⁷ Neni 19 i Statutit të Nurembergut

¹⁸ Neni 26 i Statutit të Nurembergut

¹⁹ Ligji mbi shtetet; Gerhard von Glahn, James Larry Taulbee, 2015; fq 653

²⁰ Neni 5/b i Kartës së Tokios

²¹ Ligji për sigurin ndërkombëtare; John Norton Moore, Robert F. Turner, 2005; fq 409

prej tyre u dënuan me vdekje, 16 në burgim të përjetshëm, dy vdiqën për shkaqeve natyrore gjatë gjykimit dhe 3 u shpallën të pafajshëm.²²

Pas Luftës së Ftohtë, nga OKB u krijuan disa tribunale penale ndërkombëtare ad hoc, në përgjigje të spastrimit etnik dhe mizorive të tjera, të cilat kanë ndodhur në ish Jugosllavi dhe Ruandë dhe Sierra Leone. Këshilli i Sigurimit vendosi të themelojë dy tribunale ai i Hagës dhe I Ruandës si një masë të miratuar sipas Kreut VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, ndërsa Tribunali në Sierra Leone u arrit me marrëveshje mes qeverisë dhe OKB-së. Dy tribunale u ngritën jashtë territorit në konflikt, domethënë, Tribunali për Ish-Jugosllavinë në Hagë, Holandë, dhe Tribunali i Ruandës në Arusha, Tanzani, ndërsa Tribunali për Sierra Leonen u ngrit në Fritaun. Në vitin 1991, Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë u shpërbë, duke çuar në konflikt të armatosur. Këto konflikte kanë rezultuar në shkelje të gjera dhe flagrante të ligjit ndërkombëtarë, duke përfshirë vrasjet masive, organizimin dhe paraburgimin sistematik, përdhunime dhe krime të tjera.

Këshilli i Sigurimit, organi kryesor i OKB-së përgjegjës për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare mori një sërë hapash që kulmuan në krijimin e gjykatës penale ad hoc ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë.

Gjykata nuk do të ishte subjekt i autoritetit apo kontrollit nga Këshilli i Sigurimit.²³ Statuti i Tribunalit të Hagës u miratua nga Rezoluta 827e Këshillit të Sigurimit (1993). Sipas statutit, tribunali ka juridiksion mbi krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidin, të kryer në territorin e ish - Jugosllavisë pas 1 janarit 1991, duke dhënë kështu tribunalit juridiksion të përkohshëm.²⁴

Sipas neni 5 të tribunal:

“Tribunali Ndërkombëtar ka kompetencën për të ndjekur penalisht personat përgjegjës për krimet e mëposhtme kur kryhen në konflikt të armatosur, qoftë ndërkombëtar apo të brendshëm në karakter, dhe të drejtuar kundër çdo popullësie civile”:

- a) *Vrasje;*
- b) *Shfarosja;*
- c) *Skllavërimi;*

²² Encklopedia e Luftës së II; Spencer Tucker, 2005; fq740

²³ Këshilli I Sigurimit në epokën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut; Jared Genser, Bruno Stagno Ugarte, 2014; fq 174

²⁴ Neni 3,4,5,6 I Statutit të Tribunalit të Hagës

- d) *Deportimi;*
- e) *Burgim;*
- f) *Tortura;*
- g) *Përdhunim;*
- h) *Persekutimet në baza politike, racore dhe fetare;*
- i) *Akte të tjera çnjerëzore.*

Objekti i veprës janë marrëdhëniet juridike të vendosura në statutin e TNVJ në pajtim me normat e së drejtës penale ndërkombëtare dhe konventat ndërkombëtare, për të siguruar të drejtën e të jetuarit, mbrojtjes së shëndetit dhe të drejtave e lirive themelore të popullsisë civile, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal kundër veprimeve ose mosveprimeve kriminale. Përsa i përket anës objektive ky krim kryhet me veprime aktive sipas formave të parashikuar në nenin 5 të statudit. Format e parashikuar në krimet kundër njerëzimit janë: Vrasje, shfarosja, skllavërimi, deportimi, burgim, tortura, përdhunim, persekutimet në baza politike, racore dhe fetare, akte të tjera çnjerëzore. Subjekti aktiv mund të jetë çdo person fizik që ka marrë pjesë planifikimin, përgatitjen dhe ekzekutimin, duke përfshirë dhe subjektet e posaçëm si funksionarë shtetërorë.²⁵ Subjekti pasiv është popullësia civile.

Nga ana subjektive, krimet kundër njerëzimit kryhen gjithmonë me dashje sepse kanë qëllim shkatërrimin e popullsisë civile dhe duhet të ekzistojë plani i paramenduar.²⁶ Sipas nenit 9/2 vërejmë ekzistencën e Parimit të Supremacisë nga ana e vendime të tribunalit ndaj aty të brendshme. Në vitin 1994, duke marrë parasysh masakrat e gjera dhe sistematike dhe vrasjet e civilëve, zhvendosjen dhe eksodin masiv të refugjatëve në vendet fqinje. Këshilli i Sigurimit krijoi një tjetër gjykatë ndërkombëtare penale ad hoc, këtë herë për të Ruandën. Është vlerësuar se një milion njerëz, kryesisht civilë në Tutsi, u vranë gjatë tre muajve të gjenocidit në Ruandë.²⁷ Tribunal i Ruandës u formua nga Rezoluta e Këshillit të Sigurisë 955 (1994). Ruanda duke qënë anëtare e OKB-së fillimisht e mbështeti formimin e tribunalit, por më pas votoi kundër tij. Sipas Statutit të Tribunalit të Ruandës, tribunal ka kompetencë për krimet kundër njerëzimit, gjenocid dhe shkelje të nenit 3 të Protokollit shtesë të Konventës së Gjenevës²⁸, të kryera në territorin e

²⁵ Neni 7 i Statutit të TNVJ

²⁶ Po aty

²⁷ Media dhe Genocidi i Ruandës; Allan Thompson, 2007; fq 28

²⁸ Neni 2,3,4 I Statutit Të Tribunalit të Ruandës.

Ruandës në periudhën nga 1 janari 1994 deri në 31 Dhjetor 1994.²⁹ Ky tribunal kishte përparsi mbi gjykatat kombëtare.³⁰ Sipas këtij statuti krime kundër njerëzimit përbënin aktet si: Vrasje, shfarosja, zhdukja, deportimi, burgosje, tortura, përdhunimi, përndjekjet në baza politike, racore dhe fetare, veprime të tjera çnjerëzore.³¹

Sipas nenit 6 të këtij statuti do të jetë penalisht përgjegjës kushdo që ka ndihmuar, nxitur, planifikuar, përgatitur dhe ekzekutuar, qoftë ky dhe person me detyra shtetërore. Subjekti që ky nen mbron është popullësia civile me baza kombëtare, politike, etnike, racore ose fetare.³² Gjashtu duhet ekzistenca e një sulmi të përhapur ose sistematik. Pas vitit 1991, Sierra Leone pësoi një luftë civile të shkaktuar nga një grup rebel, Frontin e Bashkuar Revolucionar (FBR) që hyri në Sierra Leone nga Liberia fqinje për të përmbysur regjimin në Sierra Leone. Pas vitit 1996, konflikti vazhdoi mes qeverisë së sapozgjedhur demokratike dhe Forcave të Mbrojtjes Civile kundër FBR, dhe më vonë kundër Këshillit Revolucionar të Forcave të Armatosura dhe FBR. Konflikti u karakterizua nga dhuna masive dhe e përhapur, duke përfshirë të gjitha format e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, përdhunimin masiv dhe rrëmbimin e grave, përdorimin e ushtarëve fëmijë dhe gjymtimin e gjerë të civilëve nëpërmjet dëmtimit të gjymtyrëve të ndryshme. Në vitin 2000, udhëheqësit e FBR dhe rebelët e tjerë u arrestuan për kryerjen e sulmeve ndaj forcave qeveritare dhe popullatës civile. Në vitin 2000, Presidenti i Sierra Leone-s deklaroi një plan për t'i kërkuar Këshillit të Sigurimit të OKB-së që të ngrinte një tribunal për Sierra Leonen, ose duke krijuar një gjykatë të posaçme ose duke zgjeruar mandatin e TNPR në territorin e saj.³³ Si përgjigje, Këshilli i Sigurimit miratoi rezolutën 1315 (2000) duke kërkuar Sekretarin e Përgjithshëm të OKB të hynte në negociata me Sierra Leone për të krijuar një gjykatë të posaçme të pavarur. Një marrëveshje midis Qeverisë së Sierra Leone dhe Sekretarit të Përgjithshëm të OKB u arrit më 16 janar 2002.³⁴

Sierra Leone duhej të ratifikonte marrëveshjen dhe të miratonte legjislacionin e zbatimit para se Gjykata të funksiononte dhe filloi gjykata i nisi punimet në korrik 2002.³⁵ Prandaj, Gjykata e re nuk u krijua nga një rezolutë e Këshillit të Sigurimit, si TNVJ dhe TNPR, por nga marrëveshja

²⁹ Neni 1 I Statutit të Tribunalit të Ruandës

³⁰ Parimi i Supremacisë- neni 8 i statutit të tribunalit të Ruandës

³¹ Neni 3 i Statutit të Tribunalit të Ruandës

³² Po aty

³³ Praktika e penale ndërkombëtare; John R. W. D. Jones, Steven Powles, 2003; fq 18

³⁴ Po aty

³⁵ Po aty

dypalëshe midis OKB dhe qeverisë së Sierra Leone. Prandaj nuk është organ ndihmës i Këshillit të Sigurimit, por një institucion i veçantë ndërkombëtar. Gjykata është përshkruar si një gjykatë sui generis në bazë të traktatit me juridiksionin dhe përbërjen e përzier. Sipas legjislacionit në fuqi të Siera Leone, gjykata nuk është pjesë e sistemit ligjor vendas. Shumica e gjyqtarëve janë gjyqtarë ndërkombëtarë të emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së dhe një pakicë gjyqtarësh emërohen nga qeveria e Sierra Leone. OKB-ja gjithashtu emëron Prokurorin dhe Sekretarin, dhe Sierra Leone vetëm një Zëvendës Prokuror.³⁶

Ashtu si TNPR dhe TNJV, GJSSL dhe gjykatat kombëtare kanë juridiksion konkurrent, por GJSSL ka përparësi mbi gjykatat kombëtare. Juridiksioni i Gjykatës mbulon krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të kryera në konflikt të brendshëm, domethënë shkeljet e nenit 3 të përbashkëta për Konventat e Gjenevës dhe të Protokollit II Shtesë të vitit 1977.³⁷ Sipas Nenit 2 të statutit: “*Krime kundër njerëzimit janë veprimet e mëposhtme si pjesë e një sulmi të përhapur apo sistematik kundër çdo popullësie civile*”:

a. *Vrajse;*

b. *Shfarosje;*

c. *Skllavërim;*

d. *Dëbim;*

e. *Burgim;*

f. *Tortura;*

g. *Përdhunimi, skllavëria seksuale, prostitucioni i detyruar, shtatëzania e detyruar dhe çdo formë tjetër seksuale;*

h. *Persekutimi në baza politike, racore, etnike ose fetare;*

i. *Akte të tjera çnjerëzore.*

Juridiksioni i Gjykatës shtrihet dhe në disa shkelje të tjera të ligjeve ndërkombëtare humanitare, të tilla si rekrutimi ose regjistrimi i fëmijëve në forcat e armatosura, si dhe krimet nën ligjin e

³⁶ Neni 12 deri neni 16 i Statutit të GJSSL

³⁷ Neni 2 deri neni 5 i Statutit të GJSSL

Sierra Leone-s, veçanërisht shkeljet që kanë të bëjnë me abuzimin e vajzave dhe shkatërrimin e të pronës. Gjykata, megjithatë, nuk ka juridiksion mbi krimin e genocidit.

Për të plotësuar sistemet penal kombëtare, në vitin 1995 u propozua, Krijimi i Gjykatës Ndërkombëtare Penale e Përhershme. Më 17 korrik 1998, pas tre vitesh diskutimi dhe një sesioni negociues pesë javor, qeveritë e mbledhura për përfundimin e konferencës diplomatike në Romë votuan për krijimin e një Gjykate Penale Ndërkombëtare të Përhershme., me seli në Hagë³⁸ Kjo gjykatë që do të ishte dhe institucioni thelbësor për të mbrojtur të drejtat e njeriut në botë, do të hynte në fuqi vetëm pasi të ishte ratifikuar nga 60 shtete.³⁹ Vetëm në 1 korrik 2002 u bë e mundur ratifikimi nga 60 shtete dhe hyrja në fuqi e Statutit të Romës, ku përfshihej dhe krijimi i kësaj gjykate. Ky statut ishte kompetente për genocide, krime kundër njerëzimit, krimet e agresionit dhe krimet e luftës.⁴⁰ Sot Statuti i Romës përbën dhe legjislacionin në fuqi për të dënuar krimet ndërkombëtare.

1.3 Definicioni i krimit të luftës

Krimet e luftës, nga vet natyra e tyre, është vështirë të trajtohen në cilëndo shoqëri në një mjedis pas konfliktit. Individët sapo kanë dal nga një periudhë e shënuar me dhunë gjatë së cilës shumë janë vrarë, përfshirë edhe anëtarë të familjes dhe shokë; disa kanë mbetur të lënduar, fizikisht dhe/ose nga ana psikologjike; shtëpitë dhe pronat janë shkatërruar; shërbimet themelore janë ndërprerë; ushqimi është i pakët; dhe shumë janë të zemëruar dhe të frikësuar. Në mes të gjithë kësaj qëndron problemi i zgjidhjes së asaj se cilat nga veprat që kanë ndodhur gjatë konfliktit ishin “*joligjore*” dhe cilat ishin pjesët “*ligjore*” të konfliktit të armatosur.⁴¹

Krimet e luftës, nga vet natyra e tyre, është vështirë të trajtohen në cilëndo shoqëri në një mjedis pas konfliktit. Individët sapo kanë dal nga një periudhë e shënuar me dhunë gjatë së cilës shumë janë vrarë, përfshirë edhe anëtarë të familjes dhe shokë; disa kanë mbetur të lënduar, fizikisht dhe/ose nga ana psikologjike; shtëpitë dhe pronat janë shkatërruar; shërbimet themelore janë

³⁸ Duke dënuar krimet ndërkombëtare; Robert Cryer, 2005; fq 183

³⁹ Neni 126 i Statutit të Romës

⁴⁰ Neni 5 i Statutit Të Romës

⁴¹ Margaret M. De Guzman, Research handbook on International Criminal Law, Bartram S. Brown, ed., Edgar Elgar Publishing, 2011

ndërprerë; ushqimi është i pakët; dhe shumë janë të zemëruar dhe të frikësuar. Në mes të gjithë kësaj qëndron problemi i zgjidhjes së asaj se cilat nga veprat që kanë ndodhur gjatë konfliktit ishin “*joligjore*” dhe cilat ishin pjesët “*ligjore*” të konfliktit të armatosur.

Kur një individ është viktimë e një vepre penale, ai ose ajo ndjehet i/e cenuar dhe shikon nga sistemi i drejtësisë penale për të sjellë drejtësinë në vend që në njëfarë mënyre të kthejë atë që është humbur. Kur krimet ndodhin në një shkallë të madhe gjatë një konflikti të armatosur, shoqëria ndjehet e viktimizuar dhe e cenuar, në mënyrë individuale ose kolektive, dhe kërkon të njëjtën ndjenjë të restaurimit të bilancit të drejtësisë. Shoqëria ka nevojë të dijë që kryesit e veprave nuk do të kalojnë pa u ndëshkuar. Ky është një hap i domosdoshëm të sjell restaurim brenda shoqërisë, para se pajtimi të mundë të fillojë në të vërtetë.

Aktet e paligjshme të cilat ndodhin gjatë një konflikti të armatosur janë definuar në mënyrë të ndryshme në juridiksione të ndryshme kombëtare apo ndërkombëtare. Megjithatë, akte të tilla në thelb përbëjnë shkelje të Konventave të Gjenevës, protokolleve të tyre, ose të ligjeve dhe zakoneve të luftës, lidhur me shkelje të ligjit ndërkombëtar humanitar, për krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid.

Në Ligjin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LP i RFJ-së) 13 krimet e tilla u përcaktuan në bazë të Konventave të Gjenevës, pasi që Jugosllavia ishte palë nënshkruese.⁴²

1.3.1 Ekspertiza në procedura gjyqësore që përfshijnë krime të luftës

Në mënyrë që rastet e krimeve të luftës të adresohen në mënyrë të duhur, gjyqtarët, prokurorët, avokatët mbrojtës dhe hetuesit duhet të posedojnë kualifikime të mjaftueshme dhe kompetencë për t’i trajtuar këto raste të ndërlikuara. Domosdoshmëria për kualifikime dhe kompetencë të tillë duhet të ishte ndër arsyetimet parësore për themelimin e një ode të specializuar të gjykatës për trajtimin e veprave serioze siç janë krimet e luftës. Përderisa është e kuptueshme se shumica e individëve që punojnë në sektorin gjyqësor nuk kanë shumë, apo nuk kanë fare trajnim ose përvojë në raste të krimeve të luftës, megjithatë është më rëndësi që këtë ta kenë ata të cilëve u

⁴² Shih Ligjin mbi Ratifikimin e Protokolleve të Gjenevës, të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ‘Medunarodni Ugovori’ në 1083, 26 dhjetor 1978. Ky ligj ka inkorporuar Konventat e Gjenevës dhe Protokollet e tyre në ligjin vendor të RSFJ-së.

është caktuar të punojnë me këto raste. Një pjesë e brendshme e rolit të përgjithshëm të komunitetit ndërkombëtar në sektorin e drejtësisë është që të ndihmojnë në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm gjyqësor. Si i tillë, gjyqtarët dhe prokurorët vendor duhet të përfshihen krahas krahas homologëve të tyre ndërkombëtar në secilin lloj rasti që është prezent në sistem. Në këtë mënyrë, kompetenca do të mund të zhvillohet derisa punohet së bashku. Gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar do të duhej të ngritin aktivitetet e tyre në rolin mentorues në lidhje me homologët e tyre vendor. OSBE konsideron se është e këshillueshme që të vazhdohet të përfshihen gjyqtarë vendor në kolegje, madje edhe në raste të krimeve të luftës, siç ka qenë praktika. Rastet e krimeve të luftës ka shumë gjasa që do të ndodhen në sistem edhe kur gjyqtarët ndërkombëtar të lëshojnë Kosovën. Akuzat për krime lufte nuk kanë të paraparë afat për parashkrim ligjor, andaj një rast i krimeve të luftës mund të ndiqet penalisht tani, ose në çfarëdo kohe në të ardhmen. Një përfitim shtesë jashtë rasteve të krimeve të luftës, në veçanti është se aftësi të tilla janë të nevojshme dhe se sfida të ngjashme siç janë frikësimi i personelit gjyqësor dhe mbrojtja e dëshmitarëve ekzistojnë edhe në raste të tjera të krimeve serioze si krimi i organizuar dhe veprat serioze penale etnikisht të motivuara. Në këtë drejtim, do të ishte mirë të gjendet një mënyrë që në të ardhmen në proces të përfshihen më shumë gjyqtarë dhe prokurorë vendor në mënyrë që ata më tej të zhvillojnë kapacitetet e tyre në këtë fushë të ligjit. Dinamikë e ngjashme do të duhej të merret parasysh edhe në lidhje me prokurorët ndërkombëtar dhe vendor të punojnë së bashku në rastet e krimeve të luftës në mënyrë që të ngjajë bartja e njohurive dhe të fitohet përvoja.⁴³

1.4 Menaxhimi me barrën e lëndëve të krimeve të luftës

Ngarkesa e përgjithshme me raste të krimeve të luftës që janë identifikuar është mjaft e madhe. Raporti i 6 prillit 2010 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara thotë që *“Njësitë për Hetimin e Krimeve të Luftës pranë EULEX-it ka përfunduar një raport gjithëpërfshirës të 888 rasteve për të cilat Prokurori nga Prokuroria Speciale e Kosovës ka parashtruar kërkesë për hetime në vitin 2009”*.⁴⁴

⁴³ Neni 6(1), KEDNJ

⁴⁴ Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, S/2009/169, 6 prill 2010, Shtojca I, pika 2. Policia. E qasur me 28.01. 2020 nga:

Ky proces është i domosdoshëm për ndjekjen e rasteve me prioritet dhe po ashtu do të çoj në një dorëzim më të mirë të këtyre rasteve tek akterët vendor në të ardhmen. Planifikimi është gjithashtu i mirë për qëllime historike, arsimore dhe për pajtim, si dhe për ngritje të vetëdijesimit të publikut atëherë kur të bëhet e dhënë publike. Përvoja, mësimet e nxjerra dhe praktikat më të mira nga GJNPJ-ja dhe të tjerëve që punojnë në rajon do të ishin të dobishme për këto qëllime. Në mënyrë që të vlerësohet se si rastet e krimeve të luftës janë trajtuar në Kosovë, duhet të merret parasysh zhvillimi i vet sistemit gjyqësor gjatë këtij dhjetëvjeçari të fundit. Përshkrimi i shkurtër që vijon, tregon kontekstin brenda të cilit janë trajtuar rastet e krimeve të luftës deri më tani në Kosovë.⁴⁵

Policia dhe drejtësia kanë qenë komponentët kryesor të UNMIK-ut kur u themelua nga Kombet e Bashkuara (KB) në vitin 1999. Menjëherë pas konfliktit, nuk ka pasur autoritete zyrtare që operonin në Kosovë përpos NATO-s (KFOR), kështu që Policia Civile e UNMIK-ut (CIVPOL) ishte themeluar shpejtë për të plotësuar nevojën për polici civile. CIVPOL-i përbëhej nga vende të ndryshme anëtare të KB-ve. Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) filloi operimet e veta në vitin 1999.⁴⁶

Megjithatë, zyrtarët e SHPK-së nuk ishin të përfshirë në hetimin e rasteve të krimeve të luftës. Sistemi Emergjent Gjyqësor (SEGJ) filloi punën nga fundi i vitit 1999 dhe vazhdoi gjatë vitit 2000. SEGJ përbëhej nga gjyqtarë dhe prokurorë vendor, shumë prej të cilëve kishin punuar si të tillë nën sistemin e vjetër Jugosllav.

Shumë nga ata nuk kishin punuar që nga fundi i viteve të 1980'ta si rezultat i ngjarjeve të cilat kanë ndodhur gjatë regjimit të Miloševićit.⁴⁷ Përderisa diskutoheshin meritat e GJKLEK-ut, u vë në pah se përkrahja do të nevojitej edhe për avokatët mbrojtës që do ti përfaqësonin të akuzuarit për krime lufte.⁴⁸ Në mënyrë për të pasur “*barazi të armëve*” të vërtetë, avokatët mbrojtës dhe prokuroria duhet të ishin në mënyrë të barabartë të pajisur mirë, në mënyrë që të ofrojnë përfaqësim kompetent për të akuzuarit. GJNPJ-ja ka mandat për të ndjekur penalisht personat

<http://www.un.org/Docs/sc/sgrep10.htm> e më pas në raporti i 6 prillit 2010.

⁴⁵ Për një përshkrim më të detajuar shih raportin e OSBE-së, Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kosovë; Shqyrtim. (shtator 2002). E qasur me 28.01 2020 në http://www.osce.org/documents/mik/2002/09/857_sq.pdf

⁴⁶ Gjenerata e parë nga Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës diplomoi në nëntor 1999

⁴⁷ Shih Shqyrtimi i parë i OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Penale në Kosovë (1 shkurt 2000 – 31 korrik 2000), Rasti Momcilovic: Raport i Përkohshëm.

⁴⁸ Shih Shqyrtimi i parë i OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Penale në Kosovë (1 shkurt 2000 – 31 korrik 2000), Rasti Momcilovic: Raport i Përkohshëm.

përgjegjës për shkelje serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që nga viti 1991.⁴⁹

Prokurorja po ashtu vëri në pah se resurset hetimore të gjykatës do të zbatohen mes tjerash edhe për *“udhëheqës të lartë civil, policor dhe ushtarak, të tjerë të cilëndo palë në konflikt, të cilët mund të mbahen përgjegjës për krimet e kryera gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë”*.⁵⁰

1.5 Informimi i publikut lidhur me trajtimin e rasteve të krimeve të luftës

Informimi është një përbërës i domosdoshëm por shpesh i anashkaluar në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës. Informimi nuk është thjeshtë lëshimi i një deklaratë për shtyp lidhur me një aktgjykim në një rast të veçantë. Shkon shumë më larg, pasi që ka të bëjë me hapa afirmativ të mara për të informuar dhe arsimuar publikun lidhur me atë se çfarë po ndodh në përgjithësi me rastet e krimeve të luftës përveç shpalljes së rezultateve në raste specifike. Kjo shërben për të çuar përpara procesin kur mbërthehet me atë se çfarë ka ndodhur gjatë konfliktit, të lejojnë njerëzit të mësojnë se çfarë është duke u ndërmarr në lidhje me këtë, dhe kështu të mundet perceptimi se kriminelët e luftës kanë vepruar pa u ndëshkuar, që rrjedhimisht mund të ndihmojë drejt pajtimit në mes të komuniteteve. Veç kësaj, komentaret dhe të gjitha materialet përkatëse të GJNPJ-së duhet të përkthehen në gjuhët e rajonit dhe të jenë të qasshme në internet. Megjithatë, jo të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë kanë lidhje interneti apo kompjuterë. Kjo duhet të konsiderohet si çështje urgjente. Së fundmi, Gjykata Supreme ka nevojë për një sallë më të madhe gjykimi për të akomoduar numrin e personave të domosdoshëm për raste të ndërlikuara me palë të shumëfishta.

⁴⁹ Shih Rastin Nr. IT-04-84-T, nga Gjykata Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë nga viti 1999, Prokurori kundër Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj, aktgjykimi i 03 prillit 2008, paragrafët 502-505. E qasur me 23.01.2020 në <http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/tjug/sq/080403.pdf>.

⁵⁰ Shih Rastin Nr. IT-03-66-T, nga Gjykata Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë nga viti 1999, Prokurori kundër Limaj, Bala dhe Musliu, aktgjykimi i 30 nëntorit 2005, paragrafët 738-743. E qasur me 23.01.2020 në <http://www.icty.org/x/cases/limaj/tjug/sq/051130.pdf>. Për ankesën shih Rastin Nr. IT-03-66-A, nga Gjykata Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë nga viti 1999, Prokurori kundër Limaj, Bala dhe Musliu, aktgjykimi i 27 shtatorit 2007, Pjesa Shtatë, Vendim. E qasur me 23.01.2020 në <http://www.icty.org/x/cases/limaj/acjug/sq/070927.pdf>.

KAPITULLI I 2

2.1 Krimet kundërnjerëzimit sipas Kodit Penal në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Anëmbanë ish-Jugosllavisë, si dhe në zonat tjera të konfliktit rreth botës, rastet e krimeve të luftës janë dëshmuar gjithmonë të jenë raste vështira për t'u hetuar dhe gjykuar plotësisht. Këto raste veç sa bëhen më vështirë të zgjidhen, aq sa më të vjetra bëhen prej ngjarjeve në fjalë. Disa viktimat dhe dëshmitarë kanë vdekur, disa janë shpërngulur dhe kujtesa e disa të tjerëve është zbehur me kalimin e kohës. Dëshmitë janë zhvendosur ose shkatërruar, pjesërisht nga dorëzimet e shumta nga gjeneratat e ndryshme të akterëve të përfshirë në këto raste.

Shumë nga hetuesit, shumica dërmuese e të cilëve kanë qenë ndërkombëtar, ka kohë që kanë lëshuar juridiksionin dhe nuk janë më në gjendje të marrin pjesë në gjykim dhe të paraqesin dëshmitë e as të japin deklaratat lidhur me rolin e vet në hetime. Republika e Maqedonisë është shtet demokratik, social në të cilën të gjithë para ligjit janë të njëjtë, ndërsa një ndër vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë ndër të tjerash është edhe respektimi i principeve demokratike dhe të drejtave të njeriut.

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë e inkriminon shkeljen e barazisë së qytetarëve në bazë të dallimit të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë kombëtare dhe sociale, besimit politik dhe fetar, dhe pozitës pronësore dhe shoqërore, gjuhës apo ndonjë veti personale apo rrethanë.⁵¹ Dënues gjithashtu është, shkelja e së drejtës për përdorimin e gjuhës dhe shkrimit.⁵² Gjithashtu të inkriminuara janë veprimet e diskriminimit me vepra të numërta penale: maltretimi apo ndonjë veprim dhe dënim tjetër i ashpër, jonjerëzor dhe nënçmues,⁵³ rrezikimi i sigurisë,⁵⁴ ofendimi,⁵⁵ provokimi i urrejtjes nacionale, racore dhe fetare, përçarjes dhe mosdurimit,⁵⁶ krimet kundër njerëzimit,⁵⁷ miratimi apo arsytimi i gjenocidit, krimet kundër njerëzimit apo krimet lufte,⁵⁸ si

⁵¹ Neni 137 nga KP

⁵² Neni 138 nga KP

⁵³ Neni 142 nga KP

⁵⁴ Neni 144 nga KP

⁵⁵ Neni 173 nga KP

⁵⁶ Neni 319 nga KP

⁵⁷ Neni 403 nga KP

⁵⁸ Neni 407-a nga KP

dhe organizimi i grupeve dhe nxitja e kryerjes së gjenocidit dhe krimeve të luftës.⁵⁹ Diskriminimi racor është i inkriminuar në nenin 417 të KP.⁶⁰

2.2.1 Gjenocidi

Gjenocidi është vrasja e qëllimshme e njerëzve në baza etnike, nacionale, racore, religjioze apo (nganjëherë) politike, si dhe veprime tjera të qëllimshme që shpijnë në eliminimin fizik të ndonjë kategorie të mësipërme. Nuk ka ujdi nëse termi gjenocid duhet të përdoret për vrasjet masive të motivuara politikisht në përgjithësi, por në përditshmëri ky term përdoret thjeshtë si vrasja masive e qëllimshme e civilëve. Ky fenomen është trajtuar në Kodin Penal të Maqedonisë, neni 403⁶¹. Në këtë nen kushdo që me qëllim të asgjësimit të tërësishëm apo të pjesërishëm të ndonjë grupi kombëtar, etnik, racor apo fetar kryen një ose më shumë nga veprimet e mëposhtme, do të dënohet me burgim së paku 10 vite ose me burgim të përjetshëm. Dënimi i i parashtruar flet për:

- 1.1. Vrasjen e anëtarëve të grupit;
- 1.2. Shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore apo mendore të anëtarëve të grupit;
- 1.3. Vënien e qëllimshme të grupit në kushte të tilla të jetës të cilat shpijnë në shfarosje të plotë apo të pjesërishme fizike;
- 1.4. Vënien e masave të cilat kanë për qëllim që të pengojnë lindjet brenda grupit;
- 1.5. Transferimin me dhunë të fëmijëve të grupit në një grup tjetër.

⁵⁹ Neni 316 – a nga KP

⁶⁰ Neni 417 nga KP

⁶¹ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Teksti i konsoliduar përmban këto ndryshime në ligj botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" Nr 80/99, Nr. 4/2002 viti, numri 43/2003, numri 19/2004, numri 81/2005, numri 60/06, numri 73/06, numri 7/08, numri 139/08, numri 114/09, numri 51/11, numri 135/11, 185/11, numri 142/12, numri 166/12, numri 55/13, numri 82/13, numri 14/14, numri 27/14, numri 28/14, numri 115/14 dhe Nr 132/14.

2.2.2 Krimet kundër njerëzimit

Sipas nenit 403 – a,⁶² një person i cili me qëllim ka shkatërimin sistematik të popullsisë civile, urdhëron vrasjen, dëmtim të rëndë trupor, shfarosje fizike, skllavërim, dëbim ose shpërngulje me forcë të popullatës, burgosje ose privimin e lirisë në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar, sjell torturë, përdhunim, shfrytëzim seksual ose skllavëri, prostitucion të detyrar, shtatzani të detyrar ose ushtron ndonjë dhunë tjetër seksuale të rëndë si ndjekje penale të ndonjë grupi ose komuniteti në baza politike, kombëtarë, etnike, kulturore fetare dhe gjinore sipas këtij neni do të dënohet me 10 burgim ose me burg të përjetshëm.

Po ashtu do të dënohet edhe për aktet e tjera ç'njerëzore që shkaktojnë me dashje vuajtjen fizike ose psikologjike të një personi që kryen aktet e përmendura më lartë.

2.2.3 Krimet kundër agresionit

Ai që ka fuqi të vërtetë për të mbikëqyrur ose menaxhuar veprimet politike ose ushtarake të shtetit ka përdorur forcat e armatosura të një shteti kundër sovranitetit, integritetit territorial ose pavarësisë politike të një shteti tjetër ose në ndonjë mënyrë tjetër të kundërt Kartës së Kombeve të Bashkuara kryen një veprim agresioni i cili, në karakteristikat, peshën dhe shkallën e tij përbën një shkëlqje të veçantë të Kartës së Kombeve të Bashkuara, dënohet me burgim të paktën pesë vjet.⁶³ Ai që merr pjesë në aksionin e forcave të armatosura të përmendura në paragrafin (1) të këtij neni, dënohet me burgim nga tre deri në pesë vjet.⁶⁴ Ai që drejtpërdrejt dhe publikisht nxit krimin e agresionit, do i dënuar një me burgim nga deri në dhjetë vjet.⁶⁵ Si agresion nga paragrafi (1) i këtij neni konsiderohet:⁶⁶

⁶² Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Teksti i konsoliduar përmban këto ndryshime në ligj botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" Nr 80/99, Nr. 4/2002 viti, numri 43/2003, numri 19/2004, numri 81/2005, numri 60/06, numri 73/06, numri 7/08, numri 139/08, numri 114/09, numri 51/11, numri 135/11, 185/11, numri 142/12, numri 166/12, numri 55/13, numri 82/13, numri 14/14, numri 27/14, numri 28/14, numri 115/14 dhe Nr 132/14.

⁶³ Po aty, neni 406-b, paragrafi (1)

⁶⁴ Po aty, neni 406-b, paragrafi (2)

⁶⁵ Po aty, neni 406-b, paragrafi (3)

⁶⁶ Po aty, neni 406-b, paragrafi (4)

- Pushtimi ose sulmi i forcave të armatosura të një shteti në territorin e shtetit tjetër, pushtimi ushtarak i përkohëshëm, përfshirja e sulmit nga një shtet në shtetin tjetër.⁶⁷
- Bombardimi nga forcat e armatosura të një shteti në territorin e një shteti tjetër ose përdorimi i ndonjë arme të një shteti në një shtet tjetër.⁶⁸
- Blokimi i portit ose vijës bregdetare të një shteti me forcat e armatosura të shtetit tjetër.⁶⁹
- Sulmimi i forcave të armatosura të një shteti në tokë, det ose Forcat Ajrore të një Shteti tjetër.⁷⁰
- Përdorimi i forcave të armatosura të një shteti në zone një Shteti tjetër, duke iu nënshtruar marrëveshjes së tij me kushtet e parashikuara marrëveshjen e tyre ose shtrirjen e pranisë ushtarake të territori i një shteti tjetër pas përfundimit të kontratës.⁷¹
- Dhënia e lejes për të përdorur territorin e një shteti të listuar në dispozicion të një shteti tjetër, për ta përdorur për agresion kundër një shteti të tretë ose⁷²
- Dërgimin nga ose në emër të shtetit në bandat e armatosura, grupe, paramilitare ose mercenare që kryejnë veprime të armatosura kundër një vend tjetër, i cili për nga pesha korrespondon me sa më sipër veprimet ose pjesëmarrja e saj e rëndësishme në veprime të tilla.⁷³

2.3 Krimet kundër populates civile

Sipas nenit 404 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut,⁷⁴ ai i cili gjatë një lufte, konflikti të armatosur ose okupimi, bën shkeljen e rregullave të së drejtës ndërkombëtare, urdhërim të një sulmi ndaj popullatës civil, vendbanimeve, civilëve të veçantë ose personave me

⁶⁷ Po aty, neni 406-b, paragrafi (1) alineja 1.

⁶⁸ Po aty, neni 406-b, paragrafi (1) alineja 2.

⁶⁹ Po aty, neni 406-b, paragrafi (1) alineja 3.

⁷⁰ Po aty, neni 406-b, paragrafi (1) alineja 4.

⁷¹ Po aty, neni 406-b, paragrafi (1) alineja 5.

⁷² Po aty, neni 406-b, paragrafi (1) alineja 6.

⁷³ Po aty, neni 406-b, paragrafi (1) alineja 7.

⁷⁴ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Teksti i konsoliduar përmban këto ndryshime në ligj botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" Nr 80/99, Nr. 4/2002 viti, numri 43/2003, numri 19/2004, numri 81/2005, numri 60/06, numri 73/06, numri 7/08, numri 139/08, numri 114/09, numri 51/11, numri 135/11, 185/11, numri 142/12, numri 166/12, numri 55/13, numri 82/13, numri 14/14, numri 27/14, numri 28/14, numri 115/14 dhe Nr 132/14.

aftësi të kufizuara për luftime që rezultojnë me vdekje, lëndime serioze trupore ose dëm serioz për shëndetin e njeriut; sulm pa zgjedhje të qëllimi i shënjestrimit të popullatës civile; kryerjen e vrasjeve, torturave, akteve çnjerëzore, eksperimente biologjike, mjekësore ose shkenca të tjera kundër popullatës civile, marrjen e indeve ose organeve për transplantim, duke shkaktuar vuajtje ose dëm të madh në integritetin ose shëndetin e trupit; zhvendosja ose rivendosja ose lindja e detyruar ose shndërrimi në një fe tjetër; detyrimi i prostitucionit ose përdhunimi, skllavëria seksuale ose shkaktimi i shtatzënisë së pavullnetshme, sterilizimi i dhunshëm ose forma të tjera të dhunës seksuale; aplikimi i masa të frikësimit dhe terrorit, marrjen e pengjeve, dënimin kolektiv, ndalimin e paligjshëm në kampe përqendrimi dhe ndalime të tjera të paligjshme, privimin e të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm; ose ekzekutimi i një dënimi ose ekzekutimi pa një gjykim paraprak të dhënë nga një gjykatë me bazë ligjore në një procedurë që siguron garanci gjyqësore të pranuar në përgjithësi për të detyruar shërbimin në forcat e armatosura të një force armike ose shërbimin ose administratën e saj të inteligjencës, për të regjistruar dhe rekrutuar persona nën 15 vjeç. forcat e armatosura të shtetit ose rekrutimin e personave nën moshën 18 vjeç në grupe të armatosura përveç forcave të armatosura të shtetit dhe përdorimin e tyre përmes pjesëmarrjes aktive në aktivitete të armatosura në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me rregullat e së drejtës ndërkombëtare; duke përfituar nga prania e civilëve ose personave të tjerë të mbrojtur si mburojë e gjallë në vende ose zona të caktuara të veprimtarisë së forcave të armatosura; detyrimi i punës së detyruar, uria e popullatës, pengimi i hyrjes në ndihmë humanitare, konfiskimi i pasurisë, plaçkitja e pasurisë, shkatërrimi i paligjshëm dhe i qëllimshëm ose përvetësimi i një pasurie në shkallë të gjerë që nuk justifikohet nga domosdoshmëria ushtarake, marrja e paligjshme, kontributi dhe kërkesa e lartë, zhvlerësimi i parave të brendshme ose lëshimi i paligjshëm i parave, ose ai që kryen ndonjë prej veprave të lartpërmendura, dënohet me burgim të paktën dhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

2.4 Krimet kundër rrobërve të luftës

Sipas nenit 406⁷⁵, Një person i cili, në kundërshtim me rregullat e së drejtës ndërkombëtare, urdhëron që të burgosurit e luftës të ekzekutohen për vrasje, tortura, trajtim çnjerëzor, eksperimente biologjike, mjekësore ose të tjera shkencore, transplantim të indeve ose organeve, vuajtje të rënda ose dëmtim të tyre. integriteti trupor ose shëndeti, për tu detyruar në shërbim në forcat e armatosura të armiku ose të privohet nga e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm ose të dënohet ose ekzekutohet pa gjykim të një gjykate të krijuar me ligj ose të procedojë duke siguruar garanci gjyqësore të pranuarra përgjithësisht ose të dëbohet, zhvendoset ose mbahet në një mënyrë të paligjshme; robëria ose ai që kryen një prej veprave të përmendura më lart mund të dënohet me burgim të paktën dhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

2.5 Përdorimi i mjeteve të pajeluaja të luftës

Ai që do t'i urdhërojë ata gjatë një lufte ose konflikti të armatosur të përdorni helme ose armë helmuese, gazra helmuese, gazra kongjestioni ose lloje të tjera të gazrave ose lëngjeve, substancave ose pajisjeve të ngjashme, deponive minierat kundër personelit, plumba që përhapen lehtësisht në trupin e njeriut, si psh plumba me një tufë të fortë që nuk mbulon tërë drithin ose është shpuar, armët, raketat, materialet ose mjetet e tjera të luftës, sipas rastit natyra shkakton lëndime të panevojshme ose vuajtje të panevojshme ose kush kanë veçoritë, në kundërshtim me të drejtën ushtarake ndërkombëtare, të jenë të padallueshme ushtarakisht për qëllime civile ose mjete të tjera të luftës ose mjeteve të luftës të ndaluara me rregullat e së drejtës ndërkombëtare ose t'i përdorin ato vetëm, do të i dënuar me burgim të paktën një vit.

⁷⁵ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Teksti i konsoliduar përmban këto ndryshime në ligj botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" Nr 80/99, Nr. 4/2002 viti, numri 43/2003, numri 19/2004, numri 81/2005, numri 60/06, numri 73/06, numri 7/08, numri 139/08, numri 114/09, numri 51/11, numri 135/11, 185/11, numri 142/12, numri 166/12, numri 55/13, numri 82/13, numri 14/14, numri 27/14, numri 28/14, numri 115/14 dhe Nr 132/14.

2.6 Lejimi apo arsyetimi i gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit ose krimeve të luftës

Sipas nenit 407-a⁷⁶ ai që mohon publikisht përmes sistemit të informacionit mohon ashpër, minimizon, aprovon, dhe justifikon veprat penale nga nenet 403-407 do të jetë i dënueshëm deri 5 vj. Kurse sipas alinesë së 2 te këtij neni nëse mohimi minimizimi apo aprovimi është kryer me qëllim të nxitjes së urrejtjes, diskriminimi ose dhunë ndaj personit për shkak të përkatësisë kombëtare, etnike, fetare dënohet me burgim të paktën 4 vj.

2.7 Keqpërdorimi i armës kimike apo biologjike

Sipas nenit 407-b të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ai që prodhon ose përsos, prodhon, prokuron, dyqanet, shet ose blen, ose ndërmjetëson në blerjen ose shitjen; zotëron transporton ose transporton armë kimike ose biologjike ose ndonjë një mjet lufte i ndaluar me rregullat e së drejtës ndërkombëtare dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet. Nëse më shumë se një person vdes për shkak të krimit të përmendur në paragrafët 1 dhe 2, kryesi dënohet me burgim të paktën pesë vjet ose me burgim të përjetshëm burgu. Objektet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 dhe mjetet për bërjen e tyre, transmetimi dhe shpërndarja do të zbriten.

2.8 Përgjegjësia e komandantëve dhe eproreve

Sipas nenit 416-b⁷⁷ Komandanti ushtarak ose personi që vepron në një kapacitet të tillë është përgjegjës penalisht për të gjitha veprat penale të përcaktuara në nenet 403 deri 416-A, të kryera

⁷⁶ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Teksti i konsoliduar përmban këto ndryshime në ligj botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" Nr 80/99, Nr. 4/2002 viti, numri 43/2003, numri 19/2004, numri 81/2005, numri 60/06, numri 73/06, numri 7/08, numri 139/08, numri 114/09, numri 51/11, numri 135/11, 185/11, numri 142/12, numri 166/12, numri 55/13, numri 82/13, numri 14/14, numri 27/14, numri 28/14, numri 115/14 dhe Nr 132/14.

⁷⁷ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Teksti i konsoliduar përmban këto ndryshime në ligj botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" Nr 80/99, Nr. 4/2002 viti, numri 43/2003, numri 19/2004, numri 81/2005, numri 60/06, numri 73/06, numri 7/08, numri 139/08, numri 114/09, numri 51/11, numri 135/11,

gjatë një lufte ose ndonjë konflikti të armatosur, ndërkombëtar ose nga brenda, nga anëtarët e formacioneve të armatosura të rregullta ose paramilitare nën komandën dhe kontrollin e tij të drejtpërdrejtë, nëse ai e dinte ose ishte në ndonjë rrethanë të detyruar dhe mund të dinte që ata po përgatiteshin ose performonin akte të tilla, ose nuk kanë marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme për t'i parandaluar ato të kryhen, ose kanë parandaluar ose dështuar në sjelljen e tyre ndjekja penale e autorëve të krimeve. Eprori është përgjegjës penalisht për të gjitha krimet e Nenet 403 deri 416-a, të kryera gjatë ose gjatë një konflikti të armatosur paqe nga vartësit e tij në kryerjen e detyrave të tij zyrtare ose të tjera; ose një detyrë, nëse ai e dinte ose në të gjitha rrethanat ishte i detyruar të ai mund të kishte ditur që ata po përgatiteshin ose po kryenin veprime të tilla, ose nuk kishte arritur ta bënte këtë të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar ekzekutimin e tyre, ose të parandaluar ose dështuar në ndjekjen penale të autorëve të krimeve.

KAPITULLI I 3

3.1 Konventat ndërkombëtare

Më 24 maj 1915, Fuqitë Aleate si Britania, Franca dhe Rusia lëshuan bashkërisht një deklaratë eksplicite duke akuzuar për herë të parë një qeveri për kryerjen e "*krimeve kundër njerëzimit*"⁷⁸. Ndryshe nga krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit mund të kryhen në paqe apo në luftë.⁷⁹ Gentili luftën e ka përkufizuar "*bellum est publicorum armorum iusta contento*"⁸⁰ përkufizim që tregon se lufta është konflikt i armatosur, që zhvillohet midis sundimtarëve dhe se duhet të jetë e drejtë. Veprat penale kundër njerëzimit kryhen gjatë kohës së luftës, udhëheqjes së operacioneve luftarake ose gjatë kohës së pushtimit të territoreve të caktuara. Por një grup i këtyre veprave penale kryhen edhe gjatë kohës së paqes siç janë: gjenocidi, gjenocidi kulturor, ndryshimit të strukturës demografike, pushtimit të territoreve, kolonizimit të territorit me

185/11, numri 142/12, numri 166/12, numri 55/13, numri 82/13, numri 14/14, numri 27/14, numri 28/14, numri 115/14 dhe Nr 132/14.

⁷⁸http://www.armenian-genocide.org/Affirmation.160/current_category.7/affirmation_detail.html

⁷⁹ Margaret M. De Guzman, RESEARCH HANDBOOK ON INTERNATIONAL CRIMINAL LAW, Bartram S. Brown, ed., Edgar Elgar Publishing, 2011

⁸⁰ Gentile Alberico, De jure belli, sipas: Adolfo Mijaja de la Muela, introduccion al Derecho Internacional Publico, Madrid, 1979, fq 435.

popullsi të së njëjtës etni me pushtuesin⁸¹, etj. Groci luftën e përkufizon si ndeshje midis atyre që shtyhen me forcë⁸², kurse sipas Calvos lufta është “*gjendje armiqësie që zëvendëson harmoninë e mirë midis kombeve ose midis qytetarëve të një vendi të cilët u takojnë partive të ndryshme politike, për të pushtuar me forcë atë që nuk është e mundur të fitohet me rrugë paqësore dhe miqësore*”⁸³. Sipas Gjykates penale ndërkombtare krimet kundër njerëzimit janë akte të caktuara të cilat kryhen si pjesë e një sulmi të gjerë apo sistematik drejtuar kundër cilësdo popullsie civile siq janë: shih⁸⁴. Ato nuk janë ngjarje të izoluara apo sporadike, por janë pjesë ose e politikave qeveritare (edhe pse autorët e krimit nuk donë ta identifikojnë veten me këtë politikë), ose nga parimi i gjerë i toleruar mizorisht ose e falur nga një qeveri apo nga autoritet shtetërore faktikisht.

Krimet kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare ndahen në tri grupe:

a) Kundër njerëzimit; b) Të luftës; dhe c) Kundër paqës;

Si krime kundër njerëzimit janë konsideruar: vrasjet, shfarosjet, skllavërimi, depërtimi, dhe veprimet e tjera jonjerëzore të kryerja ndaj popullsisë civile para ose gjate luftës⁸⁵, apo edhe përndjekja racore, apo fetare dhe veprime të tjera çnjerëzore mund të arrijnë pragun e krimeve kundër njerëzimit në qoftë se ato gjejnë mbeshtetje të gjere ne praktike ne menyre sistematike, pa marre parasysh se me kryerjen e tyre a shkelet ligji i shtetit ne te cilin janë kryer krimet.

Sipas Kodit Penal të Kosovës krimet kundër njerëzimit konsiderohen rastet kur ndokush kryen një ose me shumë nga veprat e parapara ne këtë dispozite, duke e ditur se ato janë pjese e një sulmi të gjere apo sistematik kundër popullsisë civile siç janë: Vrasja, Shfarosja, Skllavërimi, depërtimi ose transformimi i dhunshëm i popullsisë, Burgosja ose privimi tjetër serioz nga liria ne kundërshtim me rregullat themelore te se drejtës ndërkombëtare, Tortura, dhunimi, skllavërimi seksual, prostitucioni i detyruar, shtatzëna me dhunë, persekutimi i një grupi të identifikueshëm për arsye politike, fetare racore, zhdukja e detyruar e personave, krimin e aparteidit, e veprat tjera çnjerëzore.

⁸¹Ukaj Bajram, Përfarimi i vlerave të kulturës material dhe shpirtërore, Prishtinë 2000, fq. 97

⁸²Grotius Hugo, The Law of War and Peace, Indianapolis, New York 1925, fq. 33.

⁸³Ramon de Orue, Manual de Derecho Internacional Publico, Madrid 1933, fq. 474.

⁸⁴http://www.icc-cpi.int/en_menus/icc/about%20the%20court/frequently%20asked%20questions/Pages/12.aspx

⁸⁵ Kodi Penal i Kosovës, neni 149

Kryerësi i krimeve të tilla janë: çdo person që urdhëron kryerjen e njëres nga veprat e përcaktuara me këtë dispozitë, si dhe çdo personi cili kryen këto vepra. Urdhërdhënës mund të jetë personi ushtarak, civil, policor, që gjendet në pozitë të lartë të hierarkisë shtetërore i cili ka autorizime që të jep urdhra, apo mund të jetë edhe një person që nuk e ka këtë autorizim mirëpo mund të jetë kryesues i një grupi që ata e njohin dhe e kanë pranuar si udhëheqës që ata kanë pranuar ti zbatojnë urdhëratë e tij⁸⁶.

Si pasojë e luftës së dytë botërore në cilën viktima ishin me miliona njerz erdhi deri te mobilizimi i vetëdijes ndërkombtare që autorët e krimeve të mos mbeten pa u ndëshkuar. Kështu me datë 8 Gusht 1945, në Londër u arrit marrëveshja e forcave të mëdha aleate (SHBA, Franca, Anglia dhe Bashkimi Sovjetik), që të formohet gjykata ndërkombëtare ushtarake e cila do ti gjykonte kriminelët e mëdhenj të Luftës së dytë Botërore, veprat e të cilëve nuk mund të konsiderohen në kompetencën territoriale të shteteve. Idenë për themelimin e gjykatave në Nuremberg dhe Tokio e dha Presidenti Amerikan Franklin Ruzvelt në vitin 1944, kjo ide u përkrah edhe nga kryeministri britanik Uinston Çurçil dhe udhëheqësi sovjetik Stalin.

Krahas marrëveshjeve për themelimin e këtyre dy gjykatave u nxor edhe Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Ushtarake⁸⁷. Termi krime kundër njerzimit dhe civilizimit është përcaktuar për herë të parë në baza politike në statutin e Gjykatës Penale Ushtarake të Nurembergut, ku u zhvillua edhe ndjekja e pare për krime kundër njerzimit.

Holokausti vërtetoi një pikë kthese në të drejtën ndërkombëtare, duke nxitur zhvillimin e shpejtë të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe evoluimin e shpejt njëkohsisht të ligjeve penale ndërkombtare. Statuti i Nyrembergut futi nën juridiksion jo vetëm krimet e luftës, por gjithashtu edhe "krimet kundër njerzimit" dhe "krimet kundër paqës⁸⁸."

Krahas Gjykatës Penale Ndërkombëtare Ushtarake në Nuremberg, më 15 janar 1946 u formua edhe Gjykata Penale Ndërkombëtare Ushtarake në Japoni (Tokio).

Këto dy gjykata (Nuremberg dhe Tokio) janë të para gjykata penale ndërkombëtare që u themeluan në historinë e njerzimit dhe të cilat arritën ti gjykojnë kryesit e krimeve makabër dhe masive të Luftës së Dytë Botërore. Kompetence e këtyre gjykatave ka qenë dënimi i kriminelëve

⁸⁶ Po aty, fq 354

⁸⁷ Salihu.I, E Drejta Penale Ndërkombëtare, Prishtinë, 2011, fq 308

⁸⁸ Agreement for the Prosecution and Punishment of the Major War Criminals of the European Axis, art. 6, 8 Aug. 1945, Annex, 59 Stat. 1544, 82 U.N.T.S. 279, reprinted in 39 AM. J. INT'L L. 257 (Supp. 1945) [hereinafter Nuremberg Charter].

të Luftës së Dytë Botërore, veprat e të cilëve nuk mundë të konsiderohen në kompetencën territoriale të shteteve. Mirepo në gjykimet e Tokios, (kategoria C) krimet kundër njerëzimit nuk u aplikua për ndonjë të dyshuar. Pas Gjykatës së Nurembergut, nuk do të ketë me një gjykatë ndërkombëtare që do ketë juridiksionin mbi krimet kundër njerëzimit për gati 50 vjet. Por megjithatë puna vazhdoi edhe me tutje në gjetjen dhe përpunimin e definicionit për krimet kundër njerëzimit në Kombet e Bashkuara. Në vitin 1947, Komisioni për të drejtën Ndërkombëtare u ngarkua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me draftimin e një Kodi për veprat penale ose krimet kundër paqës dhe sigurisë së njerëzimit. I përfunduar pesëdhjetë vjet më vonë në vitin 1996, ky Draft Kodi definoi krimet kundër njerëzimit me një përkufizim të ri. Ky përkufizim ndryshon nga ai i cili u përdor në Nuremberg, në të cilin aktet kriminale duhej të ndodhnin "*para ose gjatë luftës*", duke krijuar kështu një lidhje në mes të krimeve kundër njerëzimit dhe të konfliktit të armatosur.

Pas gjykimeve të Nurembergut dhe Tokios 1945-1946, Tribunal tjetër ndërkombëtar me juridiksion mbi krimet kundër njerëzimit nuk u krijua për pesë dekadat e ardhshme. Në përgjigje të krimeve të kryera të viteve 1990, gjykata të ndryshme ad hoc janë krijuar me juridiksion mbi krimet kundër njerëzimit. Secila nga Statutet e Gjykatës Ndërkombëtare Penale, Tribunalet ndërkombëtare penale për ish-Jugolavii dhe për Ruandë përmbajnë definicione të ndryshme në lidhje me krimet kundër njerëzimit⁸⁹. Ndryshe nga krimet e luftës dhe gjenocidi, krimet kundër njerëzimit nuk janë të kodifikuara në një konventë ndërkombëtare, edhe pse ka aktualisht një përpjekje ndërkombëtare për të krijuar një traktat të tillë, e udhëhequr nga Iniciativa për Krimet kundër njerëzimit. Kjo initiative ka filluar në vitin 2008 nga profesoresha Leila Nadya Sadat në institutin botëror për drejtësi Whitney R. Harris me seli në Washington University School of Law dhe deri me tani ka shkuar deri në katër faza e tri prej tyre janë të kryera. Faza e parë ishte pregaditja e projektve të ndryshme, faza e dytë doli me një raport dhe është mbajtur në St. Louis nga 13 – 14 prilli, 2009⁹⁰. Faza e tretë u mbajt në Washington DC dhe rezultoi me një deklaratë për nevojën e një konvente ndërkombëtare për krimet kundër njerëzimit⁹¹. Poashtu në këtë fazë në

⁸⁹Burns, Peter, "Aspect of Crimes against Humanity and the International Criminal Court" International Centre for Criminal Law Reform and Criminal Justice Policy. p. 6.

⁹⁰April Experts Meeting Report The Crimes Against Humanity Initiative, The Harris Institute

⁹¹ Declaration on the Need for a Comprehensive Convention on Crimes Against Humanity Whitney R. Harris World Law Institute

takimin e Gjeneves me 16, 17 Maj 2014, raporti⁹². Ky institut në fjalë ka publikuar një propozim konvente me 26 nene dhe 6 anekse për parandalimin dhe dënimin e krimeve kundër njerzimit në Universitetin e Kembrixhit. Kjo propozim konvente tani veç është në shtatë gjuhë dhe është debatuar në komisionin e Kombeve të Bashkuara dhe në qeveri të ndryshme nëpër botë, propozim konventa⁹³. Në vazhdim vlen te theksohet se në vitin 2008 Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi rezolutën 1820, e cila bëri me dije se "*përdhunimi dhe forma të tjera të dhunës seksuale mund të përbëjnë krime lufte, krime kundër njerzimit ose një akt konstituiv në lidhje me gjenocidin*"⁹⁴, pra ka një plotsim me vepra tjera. E miratuar dhe e haur për nënshkrim, ratifikim e aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 2931 me datën 26 nëntor 1968. Ka hy ne fuqi me datën 11 nëntor 1970 sipas dispozitave të nenit VIII.

Shtetet pjesëmarrëse në këtë Konventë, duke rikujtuar Rezolutën 3(I) të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, datë 13 shkurt 1946 dhe 31 tetor 1947, në lidhje me ekstradimin dhe ndëshkimin e kriminelëve të luftës, dhe Rezolutën 95 (I) të 11 dhjetorit 1946, që konfirmon parimet e së drejtës ndërkombëtare të njohura nga Statuti i Gjykatës Ushtarake Ndërkombëtare të Nymbergut dhe nga vendimi i këtij gjyqi, si dhe Rezoluta 2184 (XXI) të 12 dhjetorit 1966 dhe 2202 (XII) të 16 dhjetorit 1966, nëpërmjet të cilave Asambleja e Përgjithshme ka dënuar shprehimisht si krime ndaj njerzimit nga njëra anë shkeljen e të drejtave ekonomike dhe politike të popullsisive autoktone dhe nga ana tjetër politiken e aparteidit.

Duke rikujtuar rezolutat 1074 (XXXIX) dhe 1158 (XLI) të Këshillit Ekonomik Social të OKB-së, datë 28 Korrik 1965 dhe 5 gusht 1966, në lidhje me ndëshkimin e krimeve të luftës dhe të individëve fajtorë për krime ndaj njerzimit⁹⁵.

Duke pasur parasysh se krimet e luftës dhe krimet kundër njerzimit konsiderohen si krime më të rënda të së drejtës ndërkombëtare.

Duke njohur se, nëpërmjet kësaj Konvente, është e nevojshme dhe me vend që në të drejtën ndërkombëtare të afirmohet parimi i mosparashkrimit të krimeve të luftës dhe të krimeve kundër njerzimit dhe të sigurohet universal i tij, janë marrë vesh dhe kanë miratuar Konventën për mosparashkrimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerzimit.

⁹²"Fulfilling the Dictates of Public Consciences: Moving Forward With a Convention on Crimes Against Humanity
Whitney R. Harris World Law Institute

⁹³"Proposed International Convention on the Prevention and Punishment of Crimes Against Humanity", The Crimes Against Humanity Initiative

⁹⁴<http://www.un.org/press/en/2008/sc9364.doc.htm>

⁹⁵http://www.oas.org/en/sla/dil/docs/NU_2142_XXI_eng.pdf; No. 2142 (XXI) - Organization of American States

Konventa ka hyrë në fuqi me 11 Nëntor të vitit 1970. Ish Jugosllavia ka ratifikuar dhe nënshkruar Konventën me 16 dhjetor 1968 dhe 09 qershor 1970, kurse pas shpërbërjes së saj, ratifikim dhe nënshkrimi është bërë nga republikat e pavarura : Serbia me 12 mars 2001, Mali i Zi me 23 nëntor 2006, Kroacia me 12 nëntor 1992, Bosnja dhe Hercegovina me 01 korrik 1993, Sllovenia me 06 korrik 1992. Shqipëria ka ratifikuar dhe nënshkruar Konventën më 19 maj 1971.⁹⁶

Duhet cekur se në vërejte që shtetet i kanë bërë kësaj Konvente, qëndron edhe vërejtja që ka bërë qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, duke deklaruar se dispozitat e neneve V dhe VI janë të papranueshme, sepse parandalojnë një numër të Shteteve të jenë palë të Konventës, sepse shkelin parimet e barazisë dhe sovranitetit Shteteve dhe janë në papajtueshmëri me frymën dhe qëllimet e Konventës.⁹⁷

3.2 Konventat ndërkombëtare të miratuara nga OKB

Në protokolin nr 14 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, që ndryshon sistemin e kontrollit të konventës⁹⁸, në pjesën e tretë, neni 6 alijena 3 flitet Kur heqja e jetës përbën një krim gjenocidi, kuptohet se asnjë dispozitë e këtij neni nuk i jep të drejtë një shteti palë të këtij Pakti që në asnjë mënyrë t'i shmanget çfarëdo detyrimi që ka marrë përsipër në bazë të dispozitave të Konventës për Parandalimin dhe Ndjekjen e Krimit të Gjenocidit. Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese⁹⁹ Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984 HYRË NË FUQI: më 26 qershor 1987 në përputhje me nenin 27 (1) Shtetet palë të kësaj Konvente, Duke pasur parasysh se, në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë pjesëtarëve të familjes njerëzore është themel i lirisë, drejtësisë dhe

⁹⁶https://treaties.un.org/pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=IV-6&chapter=4&lang=en#3

⁹⁷https://treaties.un.org/pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=IV-6&chapter=4&lang=en#3

⁹⁸ Konventa europiane për të drejtat e njeriut, Korrik, 2010

⁹⁹ Konventa kundër torturës dhe trajtimeve dhe dënimeve të tjera mizore çnjerëzore ose poshtëruese, Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984

paqes në botë, Duke njohur se këto të drejta burojnë nga dinjiteti i lindur i njeriut, Duke pasur parasysh se Karta u ngarkon shteteve si detyrë, sidomos nenin 55, për të nxitur respektimin universal dhe efektiv të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, Duke marrë parasysh nenin 5 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 7 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat që të dyja përcaktojnë se askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës dhe as trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, Duke marrë parasysh gjithashtu Deklaratën për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Pësimi i Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 9 dhjetor të vitit 1975, Duke dëshiruar që luftën kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese ta bëjnë sa më efektive në botë. Konventa europiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese¹⁰⁰ Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të kësaj Konvente, Duke pasur parasysh dispozitat e Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore; Duke rikujtuar se sipas nenit 3 të së njëjtës Konventë «askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese»; Duke konstatuar se personat të cilët pretendojnë se janë viktimat të shkeljeve të nenit 3 mund të mbrohen nga mekanizmi i parashikuar nga kjo Konventë; Të bindur se mbrojtja e personave të privuar nga liria, kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese mund të forcohet nga një mekanizëm jo gjyqësor, me karakter parandalues dhe i bazuar mbi vizita. Çështjet lidhur me personel të mjaftueshëm gjyqësor, kompetencë të akterëve gjyqësor, anshmëri, mbrojtje të gjyqtarëve, prokurorëve, viktimave dhe dëshmitarëve, të gjithat mund të adresohen me formimin e një gjykate ose ode speciale për shqyrtimin e rasteve të krimeve të luftës. Kjo fushë e ligjit kërkon një nivel të lartë të kuptimit të shumëllojshmërisë së vet kështu që trajnim dhe përvojë e specializuar duhet të kërkohet për ata persona të caktuar për të ndjekur, mbrojtur dhe gjykuar rastet e tilla. Për më tepër, këto raste normalisht kërkojnë për mbrojtje të shtuar të gjyqtarëve, prokurorëve, viktimave dhe dëshmitarëve. Shumë herë, dëshmitarëve u duhet përkrahje e veçantë. Krijimi i një gjykate/ode speciale do t'i lejonte gjykatës të përqendrohet ekskluzivisht në raste të krimeve të luftës, duke ofruar kështu vendosjen në prioritetin e duhur të këtyre rasteve. Që kjo të funksionojë, resurse adekuate janë të nevojshme, dhe ato të cilat nuk kanë

¹⁰⁰ Konventa europiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese Teksti i Konventës dhe raporti shpjegues Seria e traktateve europiane - nr. 126. Teksti i rishikuar në përputhje me dispozitat Protokolleve nr. 1 (STE nr. 151) dhe nr.2 - STE nr. 152), që kanë hyrë në fuqi më 1 mars 2002

mundur të drejtohen në raste tjera, pavarësisht sa urgjente të jenë. Në të kundërtën asnjë nga përfitimet e sipërpërmendura nuk do të mund të realizohej në situatën e tanishme.

3.3 Konventat e miratuara nga vendet e Bashkimit Europian

Në kuadër të rëndësisë që paraqet mbrojtja e personit njerëzor, nuk duhet lënë pa përmendur këtu edhe mbrojtjen e posaçme që sigurojnë aktet juridike ndërkombëtare, akte të cilat janë ratifikuar pothuajse nga të gjitha shtetet evropiane, duke u bërë pjesë e sistemit të brendshëm juridik të tyre. Gjatë zhvillimit të tyre, liritë dhe të drejtat e njeriut, e në veçanti liria e personit, si kategori juridike i kanë tejkaluar kufijtë dhe nivelet e disa shteteve për ta fituar rëndësinë universale, mbishtetërore, mbinacionale, si kategori e së drejtës ndërkombëtare.¹⁰¹

Në këtë mënyrë, krahas nivelit kushtetues, mbrojtja e personit njerëzor dhe të drejtave e lirive themelore të tij është sanksionuar edhe në nivel konvencional, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të dokumenteve/instrumenteve ndërkombëtare të rëndësisë së veçantë, siç janë: Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Dinjitetit të Qenieve Njerëzore në lidhje me aplikimin e biologjisë dhe të mjekësisë- Konventa mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Biomjekësisë (1997), Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut e OKB-së (1948), Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (1950) dhe Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike. Në kushtet kur përpjekjet e shoqërisë njerëzore në Evropë e më gjerë janë drejtuar drejt qëllimit të sigurimit sa më të efektshëm dhe të plotë të mbrojtjes së personit njerëzor, përfshirja e të drejtave thelbësore, në të tilla akte ndërkombëtare, ka sjellë si pasojë forcimin e mëtejshëm të mbrojtjes së personit njerëzor, të të drejtave dhe lirive themelore të tij. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut u miratua dhe u shpall nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948, duke u përqendruar në njohjen, respektimin dhe në sigurimin e të drejtave themelore dhe të patjetërsueshme të personit njerëzor, në mbrojtjen e dinjitetit dhe të vlerave të personalitetit të njeriut. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e konsideron thelbësore mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga një sistem juridik ku duhet të sundojë ligji, për këtë arsye Organizata e Kombeve të Bashkuara ka si qëllim dhe ideal të përbashkët respektimin e këtyre të drejtave dhe lirive themelore nëpërmjet marrjes së

¹⁰¹ Neni 3, Deklarata Universale e së Drejtave të Njeriut, 1948.

masave progresive kombëtare dhe ndërkombëtare nga ana e gjithë popujve e shteteve anëtare në funksion të respektimit dhe të sigurimit të këtyre të drejtave dhe lirive. Më konkretisht, kjo deklaratë është e përbërë nga 30 nene, ku një vend të rëndësishëm zënë pikërisht ato të drejta që kanë të bëjnë dhe lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me mbrojtjen e personit njerëzor, si: e drejta për jetën; ndalimi i torturës dhe e drejta për të mos iu nënshtruar asnjë dënimi çnjerëzor, mizor apo poshtërues; e drejta për respektimin e jetës private; e drejta për mbrojtjen e nderit dhe të personalitetit të njeriut; liria e mendimit dhe e shprehjes apo liria e lëvizjes së lirë. E drejta për jetën si e drejta më thelbësore që gëzon çdo person nga momenti i lindjes, sanksionohet shprehimisht në tekstin e kësaj Deklarate. Kështu, neni 3 i saj parashikon: “*Secili ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë siguri vetjake.*”¹⁰² Menjëherë pas parashikimit të së drejtës për jetën, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB-së sanksionon të drejtën për ruajtjen e integritetit fizik e trupor të njeriut, ku nenet 4 dhe 5 të saj parashikojnë, respektivisht, të drejtën për të mos iu nënshtruar skllavërisë apo robërisë, si 187 Neni 21, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Dinjitetit të Qenieve Njerëzore në lidhje me aplikimin e biologjisë dhe të mjekësisë: Konventa mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Biomjekësisë, 1997: Trupi njerëzor dhe pjesët e tij, si të tilla, nuk duhet të bëhen shkak për fitimin financiar.¹⁰³

Nisur nga kjo pikëpamje, mund të themi me plot gojë se shumë nga rregullat dhe normat ligjore që janë pjesë përbërëse e tekstit të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore lidhen specifikisht me fushën e së drejtës penale. Në këtë kontekst, përmendim këtu të drejta të tilla, si: e drejta për jetën (neni 2), ndalimi i torturës (neni 3), e drejta për liri dhe për siguri (neni 5), e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8) etj. Krahas parashikimit dhe sanksionimit të të drejtave dhe lirive themelore në Konventën Evropiane në fjalë, që tashmë është një realitet i mirënjohur nga të gjithë, garantimi dhe sigurimi i këtyre të drejtave dhe i lirive themelore realizohet edhe nëpërmjet instancave ligjvënëse të tjera. Padyshim, institucioni më i lartë i drejtësisë që përmbush këtë funksion 1 është Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut me seli në Strasburg. Sipas nenit 32 kësaj konvente, kompetenca e Gjykatës “*shtrihet në të gjitha çështjet që do t’i drejtohen asaj lidhur me*

¹⁰² Neni 4, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948: Askush nuk duhet të mbahet në robëri ose detyrimisht i nënshtruar; robëria dhe tregtia me robër janë të ndaluara në të gjitha format. Neni 5, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948: Askush nuk duhet të mbahet në robëri ose detyrimisht i nënshtruar; robëria dhe tregtia me robër janë të ndaluara në të gjitha format. A

¹⁰³ Neni 12, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948.

*interpretimin dhe zbatimin e konventës dhe të protokolleve të saj...*¹⁰⁴ Duke Lexuar këtë nen duket sikur Gjykata është interpretuesja zyrtare e kësaj konventeje.

3.4 Konventa për mos parashkrimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit

E miratuar dhe e haur për nënshkrim, ratifikim e aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 2931 me datën 26 nëntor 1968. Ka hy ne fuqi me datën 11 nëntor 1970 sipas dispozitave të nenit VIII.

Shtetet pjesëmarrëse në këtë Konventë, duke rikujtuar Rezolutën 3(I) të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, datë 13 shkurt 1946 dhe 31 tetor 1947, në lidhje me ekstradimin dhe ndëshkimin e kriminelëve të luftës, dhe Rezolutën 95 (I) të 11 dhjetorit 1946, që konfirmon parimet e së drejtës ndërkombëtare të njohura nga Statuti i Gjykatës Ushtarake Ndërkombëtare të Nymbergut dhe nga vendimi i këtij gjyqi, si dhe Rezoluta 2184 (XXI) të 12 dhjetorit 1966 dhe 2202 (XII) të 16 dhjetorit 1966, nëpërmjet të cilave Asambleja e Përgjithshme ka dënuar shprehimisht si krime ndaj njerëzimit nga njëra anë shkeljen e të drejtave ekonomike dhe politike të popullsive autoktone dhe nga ana tjetër politiken e aparteidit.

Duke rikujtuar rezolutat 1074 (XXXIX) dhe 1158 (XLI) të Këshillit Ekonomik Social të OKB-së, datë 28 Korrik 1965 dhe 5 gusht 1966, në lidhje me ndëshkimin e krimeve të luftës dhe të individëve fajtorë për krime ndaj njerëzimit¹⁰⁵.

Duke pasur parasysh se krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit konsiderohen si krime më të rënda të së drejtës ndërkombëtare.

Duke njohur se, nëpërmjet kësaj Konvente, është e nevojshme dhe me vend që në të drejtën ndërkombëtare të afirmohet parimi i mosparashkrimit të krimeve të luftës dhe të krimeve kundër njerëzimit dhe të sigurohet universal i tij, janë marrë vesh dhe kanë miratuar Konventën për mosparashkrimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit.

Konventa ka hyrë në fuqi me 11 Nëntor të vitit 1970. Ish Jugosllavia ka ratifikuar dhe nënshkruar Konventën me 16 dhjetor 1968 dhe 09 qershor 1970, kurse pas shpërbërjes së saj, ratifikim dhe

¹⁰⁴ Pradel J.; Corstens G.; Vermeulen G., E drejta penale evropiane, 2010, f. 229

¹⁰⁵ http://www.oas.org/en/sla/dil/docs/NU_2142_XXI_eng.pdf; No. 2142 (XXI) - Organization of American States

nënshkrimi është bërë nga republikat e pavarura : Serbia me 12 mars 2001, Mali i Zi me 23 nëntor 2006, Kroacia me 12 nëntor 1992, Bosnja dhe Hercegovina me 01 korrik 1993, Sllovenia me 06 korrik 1992. Shqipëria ka ratifikuar dhe nënshkruar Konventën më 19 maj 1971.¹⁰⁶

Duhet cekur se në vërejte që shtetet i kanë bërë kësaj Konvente, qëndron edhe vërejtja që ka bërë qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, duke deklaruar se dispozitat e neneve V dhe VI janë të papranueshme, sepse parandalojnë një numër të Shteteve të jenë palë të Konventës, sepse shkelin parimet e barazisë dhe sovranitetit Shteteve dhe janë në papajtueshmëri me frymën dhe qëllimet e Konventës.¹⁰⁷

3.5 Konventa për parandalimin dhe dënimin e Gjenocidit

Gjenocid nuk do të thotë shkatërrim i menjëhershëm i një kombi përveç kur arrihet vrasja masive e të gjithë anëtarëve të një kombi. Përkundrazi ka për qëllim të nënkuptojë një plan i koordinuar të veprimeve të ndryshme me qëllim të shkatërrimit të bazave thelbësore të jetesës së grupeve kombëtare me qëllim të shkatërrimit të vetë grupeve. Objektivi e këtij plani do të thotë shpërbërja e institucioneve politike dhe sociale, kulturore, gjuhësore, ndjenjave kombëtare, religjionit dhe mbijetesës ekonomike të grupeve kombëtare dhe shkatërrimin e sigurisë personale, lirisë, shëndetësisë, dinjitetit e madje edhe jetët e individëve të cilët janë pjesë e grupeve të tilla. Sipas Konventës për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit¹⁰⁸

Konventa përcakton veprimet të cilat përbëjnë krimin e gjenocidit. Sipas saj, (neni 2) gjenocid konsiderohet cildo nga veprimet e mëposhtme, i kryer me qëllim që të zhduket plotësisht ose pjesërisht një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar. Këtu bën pjesë:

- (a) vrasja e anëtarëve të grupit;
- (b) lëndimi i rëndë fizik ose mental i anëtarëve të grupit;
- (c) vënia e grupit qëllimisht në aso kushte të jetës që duhet të sjellin zhdukjen e plotë fizike ose të pjesshme të tij;

¹⁰⁶https://treaties.un.org/pages/VieëDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=IV-6&chapter=4&lang=en#3

¹⁰⁷https://treaties.un.org/pages/VieëDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=IV-6&chapter=4&lang=en#3

¹⁰⁸ Konventës për Gjenocid, Konventës për Pengimin dhe Dënimin e krimit të Gjenocidit) Adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 9 dhjetor 1948, bërë nga Republika e Shqipërisë më 12 maj 1955

- (d) ndërmarrja e masave drejtuar në pengimin e lindjeve brenda grupit; dhe
- (e) transferimi i dhunshëm i fëmijëve nga një grup në tjetrin.

Aktet që i kryejnë autoritetet shtetërore ose personat privatë, me qëllim që të zhduket në tërësi ose pjesërisht grupi kombëtar, etnik, racor ose religjioz si i tillë, që përfshijnë:

- (a) vrasjen e anëtarëve të grupit;
- (b) shkaktimin e lëndimeve serioze trupore ose mentale anëtarëve të grupit;
- (c) imponimin e qëllimshëm të aso kushteve të jetesës që synojnë zhdukjen e plotë ose të pjesëshme fizike;
- (d) imponimin e masave me qëllim të pengimit të lindjeve brenda grupit; dhe
- (e) transferimin e dhunshëm të fëmijëve nga grupi në grupin tjetër"

KAPITULLI I 4

4.1 Raste nga praktika lidhur me veprat penale kundër njerëzimit

Pos në Maqedoni, në vendet e tjera post-jugosllave zhvillohen gjykime për krime të luftës, të kryera në konfliktet e armatosura nga muaji janar i vitit 1991 deri në muajin qershor të vitit 1999. Për të gjitha gjykimet është karakteristike se zgjasin shumë dhe që viktimat nuk janë të informuara për përparimin e procedurës, në të cilën kanë dëshmuar. Praktika e pabarabartë gjyqësore në zbatimin e ligjit në procesimin e krimeve të luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë seriozisht e rrezikon barazinë e të dyshuarve, të të akuzuarve dhe të të dënuarve para ligjit. Në procedurat për krimet e luftës, në nivel të entiteteve dhe të distriktit të Brçkos, zbatohet Ligji Penal i RSFJ-së, kurse Ligji Penal i B dhe H zbatohet në Gjykatën e B dhe H. Për shkak të kundërshtimit të Republika Srpska, e cila i referohet Marrëveshjes së Dejtonit, nuk ka Gjykatë Supreme në B dhe H, arsye kjo për të cilën procedura ankimore është në kompetenca të Gjykatës së BdheH, e cila gjykimet i kryen në procedurën e shkallës së parë. Bartja e kompetencave për gjykim për krimet e luftës në gjykata më të ulëta shkon ngadalë. Në periudhën prej vitit 2006 deri në vitin 2011, në tërësi janë bartur 83 lëndë në gjykatat me kompetenca vendore. Prej tyre, në tërësi 52 lëndë janë caktuar në gjykatat në FB dhe H, 27 në gjykatat në RS, dhe një lëndë në Gjykatën Themelore në distriktin e Brçkos në B dhe H.

Obligimet e reja të gjykatave kantonale dhe të qarkut e kërkojnë mbështetjen përkatëse teknike, profesionale dhe financiare, në mënyrë që gjykimet të zhvillohen në mënyrë profesionale dhe pa shkelje të së drejtës në gjykimin fer dhe të drejtë. Instituti i pranimit të fajit, me pjesëmarrjen e shoqatave të viktimave në sjelljen e vendimeve mbi përmbarimin në rastin konkret, dëshmohej si një instrument përkatës i drejtësisë penale në raport me rrjedhën e madhe të kohës nga kryerja e krimeve të luftës, vjetërsia e viktimave dhe e dëshmitarëve dhe me nevojën e viktimave për të përjetuar pendimin publik dhe kërkimfaljen e kryerësve. Gjykimet janë më intensivët në Gjykatën e B dhe H, i cila që nga themelimi e deri në fund të vitit 2011 me vendime të plotfuqishme ka dënuar 88 persona dhe ka përfunduar gjithsejtë 78 raste për vepra penale të krimeve të luftës, krime kundër njerëzimit, gjenocid dhe shkelje të tjera të rënda të zakoneve ndërkombëtare të luftës. Mbyllja e negociatave mbi kapitullin 23, mbi drejtësinë dhe të drejtat themelore ka sjellë, me anë të sinergjisë së kritikës së institucioneve ndërkombëtare dhe të organizatave të të drejtave të njeriut si dhe rekomandimit të Komisionit Evropian, deri te përmirësimi i kuadrit juridik në të cilin kryhet procesimi i krimeve të luftës në Republikën e Kroacisë. Me ndryshimet e Ligjit mbi zbatimin e Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë është futur kompetenca ekskluzive e gjykatave të qarkut në Osijek, Rijekë, Split dhe Zagreb, si dhe mundësia e shfrytëzimit të provave të mbledhura nga GJPNJ në procedurat penale në Republikën e Kroacisë. Në vitin 2011 është bërë progres në procesimin e krimeve të luftës. Trysnia e Amnesty International dhe e organizatave vendore për të drejtat e njeriut gjatë vitit 2011 ka kontribuar që Prokuroria Shtetërore e Republikës së Kroacisë (PSHRK) të ngrit aktakuzë kundër Tomislav Merçepit, këshilltarit të luftës në MPB-në e Republikës së Kroacisë, dhe Vlladimir Milankoviçit, komandantit të njësisë aktive dhe rezervë në formacion të DP në Sisak gjatë vitit 1991 dhe 1992. Megjithëkëtë, pos këtyre disa shembujve edhe më tutje nuk ka hetime kundër eprorëve politik dhe ushtarak në rastin e veprave penale kundër pjesëtarëve të grupit të pakicave kombëtare. Me gjithë ekzistimin e informatave dhe provave publikisht të qasshme, të shfrytëzuara në procedurat penale të përfunduara, ende nuk ka filluar procedura kundër Vlladimir Sheksit, në kohën e luftës kryetar i Shtabit të Krizës për Sllavoninë Lindore, i cili, siç pohohet, është i përfshirë në krimet e kryera në Osijek në vitin 1991. Viktimat, vetëm në disa lëndë gjatë të dëshmuarit në seancat kryesore gjyqësore, janë përjashtuar nga publiku. Arsyetimet, të cilat i përcjellin dënimet e ulëta me burgosje, dhe aktgjykimet me të cilat të akuzuarit lirohen nga akuzat, e zbulojnë anshmërinë e gjyqtarëve ndaj pjesëtarëve të policisë dhe

të ushtrisë së Kroacisë. Gjyqtarja e Gjykatës së Qarkut në Sisak, Snjezhana Mrkoc, me rastin e arsyetimit të aktgjykimit me të cilin të akuzuarit lirohen nga akuzat lidhur me katër pjesëtarë të UK, në muajin nëntor të vitit 2010, ka thënë: „*Më vjen jashtëzakonisht shumë keq që duhet t'i dënoj pjesëtarët e ushtrisë së Kroacisë për vepra penale, të cilat jemi mësuar t'i bëjë ana e kundërt, posaçërisht tash kur i ndezim qirinjtë për Vukovarin.* “ Shpalljen e aktgjykimit të shkallës së parë të Hagës për gjeneralët Ante Gotovina dhe Mladen Markač e kanë përcjellë komente paushalleske politike, ngritja e të gjykuarve në pedestalin e heronjve kombëtar, organizimi i protestave të përkrahjes anë e kënd Kroacisë, injorimi i gjetjeve faktike dhe i vuajtjeve e padrejtësisë, të cilat janë bërë ndaj viktimave. Legjislacioni i Republikës së Serbisë nuk është në harmoni me standardet të cilat i ka vendosur GJPNJ në pikëpamje të përgjegjësisë komanduese. Në legjislacionin penal të Serbisë nuk ka institucion të përgjegjësisë komanduese. Nuk ka as vullnet politik që të gjykohej gjeneralët. Edhe pse GJPNJ me aktgjykimin e saj të shkallës së parë e ka gjykuar pothuajse gjithë kreun e dikurshëm shtetëror të Republikës së Serbisë, kjo nuk ka sjellë deri tek fillimi i procedurave penale kundër oficerëve të lartë të ushtrisë dhe të MPB-së, në zonat e përgjegjësisë së të cilëve ka pasur krime masive të luftës. Hetimet, të cilat i përgatit dhe i fillon Prokuroria për Krimet e Luftës e Republikës së Serbisë (PKL) zgjasin shumë dhe në një numër relevant të rasteve nuk rezultojnë me aktakuzë. Në lidhje me krimet masive, të kryera në BNK të Dubravës në Kosovë, PKL ka filluar të veprojë në vitin 2008, por deri në fund të vitit 2011 nuk i ka hapur hetimet. Në lidhje me akuzat penale të FDH-së kundër komandantit të togut të Dhjetë Diversant të Ushtrisë së Republika Srpska, Millorad Pelemishit, të muajit gusht të vitit 2010, PKL publikisht ka njoftuar për fillimin e procedurës penale, por kjo nuk ka ndodhur deri në fund të vitit 2011. PKL gjatë vitit 2011 i ka gjykuar gjithsejtë nëntë persona. Prej tyre, vetëm njëra aktakuzë, (kundër tre të akuzuarve) përbënë një procedurë të re, kurse aktakuzat kundër gjashtë të tjerëve kanë dalë nga dy procedura të mëhershme të Departamentit për Krime të Luftës të Gjykatës së Lartë në Beograd. Në lëndët e krimeve të luftës, të kryera në Kosovë, PKL shpesh ngrit aktakuza në bazë të hetimeve pjesërisht të zhvilluara, siç është lënda e Suharekës dhe e Qyshkut. Është praktikë e PKL që të ndryshojë aktakuzat para sjelljes së aktgjykimit, duke e zvogëluar përgjegjësinë e të akuzuarve në pozita komanduese, siç është rasti në lëndën Zvornik II i akuzuari Popović dhe Grujiq. Edhe në vitin 2011, lëndë të bartura ka pasur më shumë se procedura të reja, si para Departamentit për Krime të Luftës të Gjykatës së Lartë në Beograd, ashtu edhe para Gjykatës së Apelit në Beograd. Si

edhe në vitin 2010, Gjykata e Apelit në Beograd, edhe në vitin 2011 ka vazhduar të konfirmoj dënimet e ulëta me burgosje të gjykatës së shkallës së parë. Shembulli më negativ është lënda Zvornik II, në të cilën i akuzuari Branko Popoviq është dënuar me 15vite burgosje, kurse i akuzuari Branko Grujiq me dënim me burgosje në kohëzgjatje prej gjashtë vitesh. Duke pasur parasysh se ata të dy, në kohën e kryerjes së krimeve, si bartës të pushtetit civil dhe ushtarakë në komunën e Zvornikut, sipas natyrës së funksioneve të tyre kanë qenë më të përgjegjshmit, se kanë qenë pjesëmarrës aktiv në realizimin ose, madje, organizator të planit mbi dëbimin e popullatës civile nga territori i komunës së Zvornikut, lartësia e dënimit, e cila iu është shqiptuar, është skajshmërisht joproporcionale. Mbrojtja e dëshmitarëve insajderë shkaktonte brengosje të madhe, posaçërisht kur kihet parasysh raporti mbi veprime të paligjshme në procesimin e krimeve të luftës, të cilin FDH ua ka dërguar institucioneve shtetërore në Ligji Penal i Kosovës i përgjigjet më shumë kërkesave të së drejtës ndërkombëtare se sa Ligji Penal i RSFJ-së.

Ligji Penal i Kosovës përfshin dhunimet dhe përgjegjësinë komanduese të komandantit ushtarak ose të personit, i cili në mënyrë efektive vepron si komandant ushtarak dhe i cili mundet, në rrethana të caktuara, për të qenë përgjegjës për veprimet e të gjithëve nën kontrollin e tij efektiv, ndryshe nga Ligji Penal i RSFJ-së, i cili e njeh vetëm përgjegjësinë penale për urdhërim dhe kryerje të krimeve të luftës. Në gjykatat në Kosovë për trajtim presin më shumë se 200.000 lëndë të mbetura. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në muajin nëntor të vitit 2010, e ka miratuar Strategjinë Kombëtare për uljen e lëndëve të vjetra të pazgjidhura, por zbatimi i kësaj strategjie ende nuk ka dhënë rezultate të dukshme. Problemet, siç janë trysnitë politike, mungesa dhe joprofesionalizmi i prokurorëve dhe i gjykatësve vendor, edhe më tutje janë aktuale. Në vitin 2010, EULEX-i, i cili është përgjegjës për gjykimet për krime të luftës, ka qenë i angazhuar më shumë në lëndët e kriminit të organizuar, të korrupsionit, të keqpërdorimit të pozitës zyrtare si dhe në procedurat sipas ndihmës së jashtëzakonshme juridike, kurse më pak në gjykimet për krime të luftës. Në vitin 2011, ka pasur më shumë hetime të përfunduara, të cilat kanë rezultuar me konfirmimin e aktakuzave, me aktgjykime të shkallës së parë dhe të plotfuqishme. Është e rëndësishme që prokurorët vendor kanë qenë të angazhuar në dy lëndë të krimeve të luftës. Në lëndën Prokurori kundër Slobodan Martinoviçit dhe të tjerëve, prokurori vendor e ka marrë lëndën në fazën e seancës gjyqësore kryesore, kurse në lëndën Prokurori kundër Zoran Koliçiq, prokurori vendor i ka udhëhequr hetimet. Mbrojtja e dëshmitarëve është problemi më i madh në procesimin e krimeve të luftës në Kosovë. Në muajin korrik të vitit 2011, Kuvendi i Kosovës ka miratuar

Ligjin mbi Mbrojtjen e Dëshmitarëve, i cili parasheh themelimin e Komisionit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, i cili vendos për fillimin, kohëzgjatjen dhe përfundimin e programit të mbrojtjes. Shqetësim të madh shkakton dispozita, e cila parasheh “regjim special për dëshmitarët e mbrojtur në burgje dhe në shtëpi ndëshkuese korrektuese”. Në lëndën Bukovica, aktgjykimi është shfuqizuar në muajin qershor të vitit 2011 dhe lënda është kthyer në gjykim të përsëritur. Aktgjykimi tjetër, me të cilin lirohen të akuzuarit, në këtë lëndë është sjellë në fillim të muajit tetor të vitit 2011. Të dyja aktgjykimet kanë shkaktuar kritikë të ashpër të organizatave joqeveritare për të drejtat e njeriut. Në Maqedoni nuk ka gjykime për krime të luftës. Ligji mbi Amnistinë është miratuar në vitin 2002, me çka është mundësuar amnistia e të gjithë pjesëtarëve shqiptarë të formacioneve të armatosura për të cilët ka pasur dyshime se kanë kryer krime të luftës, me përfundim në datën 6 shtator të vitit 2001. Sipas këtij Ligji, amnistia nuk ka pasur të bëjë me të akuzuarit kundër të cilëve është ngritur procedurë para GJPNJ.

Me nismën e partive politike shqiptare (Partia Demokratike e Shqiptarëve – PDSH, Bashkimi Demokratik për Integrim - BDI), në datën 19 korrik të vitit 2011 është iniciuar procedura e votimit në Parlamentin e Maqedonisë¹⁰⁹ për mbështetjen e shumicës për interpretimin autentik të Ligjit mbi Amnistinë. Të njëjtën ditë, nisma është miratuar me 63 vota për kurse 29 kundër, me çka është hequr dorë nga drejtësia penale për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut gjatë konfliktit të armatosur në Maqedoni.² Interpretimi autentik i Ligjit mbi Amnistinë ka mundësuar që amnistia të zbatohet edhe në personat e dyshuar në lëndët të cilat GJPNJ ia ka kthyer Maqedonisë për procedurë. Krimet ndaj shqiptarëve ende nuk janë procesuar. Lënda Humnera ndodhet me vite në Prokurorinë Themelore Publike dhe sipas Ligjit mbi Amnistinë do të mbyllet. Në zonën e Humnerës, midis Kiçevës dhe Dibrës, është gjetur varreza me mbetje mortore të personave të cilët janë zhdukur gjatë konfliktit të vitit 2001: Radoslav Ginov, shtetas bullgar, dhe tre shqiptarë nga Maqedonia - Islam Veliu, Hajredin Halimi dhe Ibrahim Veliu. Prokuroria nuk ka ngritur aktakuzë. Të dyshuarit për vrasje të këtyre viktimave janë pjesëtarë të paemëruar të organeve të rregullta të sigurimit. Në Slloveni nuk ekzistojnë gjykatat dhe prokuroria të cilat në mënyrë të veçantë janë kompetente për krimet e luftës, kurse nuk ekziston as edhe shërbimi i veçantë për mbështetje të dëshmitarëve.¹¹⁰ Në rrjedhë e sipër janë dhjetë procedura për krime të

¹⁰⁹ Konflikti i armatosur në Maqedoni ka zgjatur nga muaji janar deri në muajin nëntor të vitit 2001

¹¹⁰ Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave Raport për vitin 2010-2011, mundësuar nga <http://recom.link/wp-content/uploads/2014/12/Drejt%C3%ABsia-tranzicionale-n%C3%AB-vendet-post-jugosllave-Raport-p%C3%ABr-vitin-2010-2011.pdf>

luftës kundër popullatës civile dhe shkeljes së Konventave të Gjenevës. Procedurat zgjasin pothuajse 20 vite, në mungesë të të akuzuarve. Rasti më i njohur është procedura penale para gjykatës në Murska Sobota, kundër oficerit të ish APJ-së, kolonelit Berisllav Popovit dhe gjeneralit Vllada Trifunoviq, shtetas të Republikës së Serbisë. Të dyja aktakuzat në muajin prill të vitit 2008 janë bashkuar dhe shkrirë në një. Prokuroria në Murska Sobota i ka akuzuar Trifunoviqin dhe Popovin sipas bazës së përgjegjësisë komanduese për krime të luftës ndaj civilëve me rastin e intervenimit të APJ-së në Slloveni në vitin 1991.¹¹¹ Pos në Maqedoni, në vendet e tjera post-jugosllave zhvillohen gjykime për krime të luftës, të kryera në konfliktet e armatosura nga muaji janar i vitit 1991 deri në muajin qershor të vitit 1999. Për të gjitha gjykimet është karakteristike se zgjasin shumë dhe që viktimat nuk janë të informuara për përparimin e procedurës, në të cilën kanë dëshmuar.

Praktika e pabarabartë gjyqësore në zbatimin e ligjit në procesimin e krimeve të luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë seriozisht e rrezikon barazinë e të dyshuarve, të të akuzuarve dhe të të dënuarve para ligjit. Në procedurat për krimet e luftës, në nivel të entiteteve dhe të distriktit të Brçkos, zbatohet Ligji Penal i RSFJ-së, kurse Ligji Penal i BdheH zbatohet në Gjykatën e BdheH. Për shkak të kundërshtimit të Republika Srpska, e cila i referohet Marrëveshjes së Dejtonit, nuk ka Gjykatë Supreme në BdheH, arsye kjo për të cilën procedura ankimore është në kompetenca të Gjykatës së BdheH, e cila gjykimet i kryen në procedurën e shkallës së parë. Bartja e kompetencave për gjykim për krimet e luftës në gjykata më të ulëta shkon ngadalë. Në periudhën prej vitit 2006 deri në vitin 2011, në tërësi janë bartur 83 lëndë në gjykatat me kompetenca vendore. Prej tyre, në tërësi 52 lëndë janë caktuar në gjykatat në FBdheH, 27 në gjykatat në RS, dhe një lëndë në Gjykatën Themelore në distriktin e Brçkos në BdheH. Obligimet e reja të gjykatave kantonale dhe të qarkut e kërkojnë mbështetjen përkatëse teknike, profesionale dhe financiare, në mënyrë që gjykimet të zhvillohen në mënyrë profesionale dhe pa shkelje të së drejtës në gjykimin fer dhe të drejtë. Instituti i pranimit të fajit, me pjesëmarrjen e shoqatave të viktimave në sjelljen e vendimeve mbi përmbarimin në rastin konkret, dëshmohej si një instrument përkatës i drejtësisë penale në raport me rrjedhën e madhe të kohës nga kryerja e krimeve të luftës, vjetërsia e viktimave dhe e dëshmitarëve dhe me nevojën e viktimave për të përjetuar pendimin publik dhe kërkimfaljen e kryerësve. Gjykimet janë më intensivët në

¹¹¹ Gjenerali Trifunoviq: Nuk do të shkoj në gjykim”, faqja e internetit Radio Evropa e Lirë, 14 korrik i vitit 2010. http://www.slobodnaevropa.org/content/general_trifunovic_optuzen_za_ratni_zlocin_u_sloveniji/2099828.html.

Gjykatën e BdeH, i cili që nga themelimi e deri në fund të vitit 2011 me vendime të plotfuqishme ka dënuar 88 persona dhe ka përfunduar gjithsejtë 78 raste për vepra penale të krimeve të luftës, krime kundër njerëzimit, gjenocid dhe shkelje të tjera të rënda të zakoneve ndërkombëtare të luftës. Mbyllja e negociatave mbi kapitullin 23, mbi drejtësinë dhe të drejtat themelore ka sjellë, me anë të sinergjisë së kritikës së institucioneve ndërkombëtare dhe të organizatave të të drejtave të njeriut si dhe rekomandimit të Komisionit Evropian, deri te përmirësimi i kuadrit juridik në të cilin kryhet procesimi i krimeve të luftës¹¹² në Republikën e Kroacisë. Me ndryshimet e Ligjit mbi zbatimin e Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë është futur kompetenca ekskluzive e gjykatave të qarkut në Osijek, Rijekë, Split dhe Zagreb, si dhe mundësia e shfrytëzimit të provave të mbledhura nga GJNPJ në procedurat penale në Republikën e Kroacisë.

Në vitin 2011 është bërë progres në procesimin e krimeve të luftës. Trysnia e Amnesty International dhe e organizatave vendore për të drejtat e njeriut gjatë vitit 2011 ka kontribuar që Prokuroria Shtetërore e Republikës së Kroacisë (PSHRK) të ngrit aktakuzë kundër Tomisllav Merçepit, këshilltarit të luftës në MPB-në e Republikës së Kroacisë, dhe Vlladimir Milankoviçit, komandantit të njërive aktive dhe rezervë në formacion të DP në Sisak gjatë vitit 1991 dhe 1992. Megjithëkëtë, pos këtyre disa shembujve edhe më tutje nuk ka hetime kundër eprorëve politik dhe ushtarak në rastin e veprave penale kundër pjesëtarëve të grupit të pakicave kombëtare. Me gjithë ekzistimin e informatave dhe provave publikisht të qasshme, të shfrytëzuara në procedurat penale të përfunduara, ende nuk ka filluar procedura kundër Vlladimir Sheksit, në kohën e luftës kryetar i Shtabit të Krizës për Sllavoninë Lindore, i cili, siç pohohet, është i përfshirë në krimet e kryera në Osijek në vitin 1991.¹¹³

¹¹²Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave Raport për vitin 2010-2011, mundësuar nga <http://recom.link/wp-content/uploads/2014/12/Drejt%C3%ABsia-tranzicionale-n%C3%AB-vendet-post-jugosllave-Raport-p%C3%ABr-vitin-2010-2011.pdf>

¹¹³Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave Raport për vitin 2010-2011, mundësuar nga <http://recom.link/wp-content/uploads/2014/12/Drejt%C3%ABsia-tranzicionale-n%C3%AB-vendet-post-jugosllave-Raport-p%C3%ABr-vitin-2010-2011.pdf>

4.2 Historiku i konfliktit në Kosovë 1998-1999

Pushtuesit e viseve të huaja nuk dallojnë shumë për nga qëllimet e tyre, por dallojnë për nga mënyrat, metodat dhe mjetet që përdorin për realizimin e tyre¹¹⁴. Lëvizja kombëtare shqiptare, në fund të dekenies së parë të shekullit XX kishte arritur rezultate të konsiderueshme. Rrjedhojë e këtyre përpjekjeve ishte edhe 28 Nëntori 1912, kur Shqipëria u shpall e pavarur. Me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër në vitin 1913, më tepër se gjysma e trevave shqiptare u shkëputen nga shteti i posaçërisht shqiptar. Nën okupimin e Serbisë dhe Malit të Zi u përfshinë territore që kapnin rreth 22 mijë kilometra katror. Popullsia shqiptare nuk i ndërpreu përpjekjet për çlirim me gjithë terrorin që u ushtrua mbi të. Për të shtypur këtë qendër se dhe për të ndryshuar strukturën etnike të popullsisë në dobi të elementit sllav, qeveritë Serbe dhe Malazeze vendosën pushtetin ushtarak-politor dhe ndoqën në vazhdim një politikë shoviniste të përcjellë me veprime gjenocidi¹¹⁵. Ndër veprimet me karakteristike dhe më të shpeshta të ushtrisë serbe e malazeze në fazën e parë të pushtimit të viseve shqiptare (1912) ishte ndezja e fshatrave se bashku me banorët dhe pasuria e tyre e më vonë grabitja e pronave. Një mjek antare i kryqit të kuq rrefën: *“Numri i fshatrave të djegura, nga ushtria serbe nuk dihet, por për çdo ditë i kam parë nga larg ato të djegura”*¹¹⁶. *“Tri ditë e netë e kam parë flakën e fshatrave të djegura e cila e kishte skuqur qiellin”*¹¹⁷. Sekretari i mëparshëm i kryeministrit Pashiq, Tomic rrëfen së gjatë udhëtimin të tij prej Prizrenit në Pejë në të dy anët e rrugës ka parë vetëm fshatra të djegura të cilat ishin bërë rrafsh me tokë¹¹⁸.

Pas një historie të gjatë të luftës për barazi nën sundimin serb, Kushtetuta jugosllave e vitit 1974 i dha Kosovës autoritet të plotë juridik mbi territorin e saj, duke ia ngritur statusin nga një krahinë autonome brenda Serbisë, në afërsisht status të njëjtë me 6 republikat e tjera të federatës¹¹⁹. Kushtetuta i dha Kosovës përfaqësim të drejtpërdrejtë dhe të barabartë në të gjitha organet vendim-marrëse, me të drejtë të vetos. Nuk mund të merrej as një vendim në nivel federal apo atë të Serbisë pa pajtimin e Kosovës.

¹¹⁴ Dr. Kasumi Haki, Kosova, Instituti I Historise Prishtine, (1996), fq 108

¹¹⁵ Dr. Kasumi Haki, Kosova, Instituti I Historise Prishtine, (1996), fq 107; Djegiet e fshatrave dhe grabitjet e pronave toksore

¹¹⁶ Leo Freundlich Albaniens Golgatha, Wiena, 1913, 18

¹¹⁷ Po aty

¹¹⁸ Leo Freundlich, Albaniens Golgatha, Wiena, 1913, 18

¹¹⁹ Malcom Noel, Kosova: Histori e shkurtër,(1998), fq 314-333.

Gjithashtu, ajo i garantonte Kosovës të drejtën në Kushtetutën e saj, që të krijoj të gjitha institucionet e nevojshme dhe legjitime, përfshirë edhe kuvendin, qeverinë, gjyqësinë dhe policinë. Pavarësisht nga këto ndryshime, mospërfillja ekonomike e federatës për Kosovën vazhdoi përgjatë dekadave të ardhshme, siç vazhdoi trajtimi i shqiptarëve të Kosovës si qytetarë të dorës së dytë¹²⁰. Kjo ndihmoi në rritjen e kërkesës për republikë të plotë. Më 1981, ajo që filloi si protestë e studentëve për kushte më të mira në Universitetin e Prishtinës, shpejt u kthye në demonstrata të mëdha përgjatë gjithë Kosovës me kërkesat për barazi, përmirësim të kushteve ekonomike dhe për Kosovën Republikë¹²¹. Forcat policore serbe i shuan demonstratat me dhunë dhe brutalitet, gjë që solli një numër të paqartë të vdekjeve. Në këtë pikë, polarizim mes shqiptarëve dhe serbëve u rrit. Këto ngjarje mbeten simbol i refuzimit të qartë të sundimit serb nga ana e shqiptarëve të Kosovës, e që prej atëherë filloj të rritej gjithnjë e më shumë¹²². Gjatë viteve të '80-ta Slllobodan Milosheviqi filloi të ngjitej në pushtet dhe më 1989 kur u bë kryetar i Serbisë. Një nga masat e tij për shfuqizimin e statusit autonom të Kosovës, rezultoi me anulimin jo-kushtetues të autonomisë së Kosovës, në mars të vitit 1989, dhe vendosjen e asaj që ishte provuar nga shumica shqiptare si një regjim apartheidi. Nga 1989 deri më 1991, Serbia në mënyrë sistematike i shtypi shqiptarët e Kosovës dhe i suspendoi institucionet e saja, i ndërpreu sistemin e arsimit dhe shëndetësisë dhe largoi rreth 150,000 shqiptarë nga puna në polici, arsim, ndërmarrje shoqërore etj¹²³. Kjo çoi në ndërtimin e qeverisë të organizuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e të ndjerit kryetarit Ibrahim Rugova. Për dallim prej kombeve të tjera të ish-Jugosllavisë, shqiptarët zgjodhën rrugën e rezistencës së pa dhunshme dhe zgjedhjen paqësore të konfliktit.

Kjo pozitë u shikua me admirim nga shtetet perëndimore të cilat megjithatë dështuan ta shfrytëzojnë këtë mundësi për të zgjedhur problemin e Kosovës¹²⁴.

Më 1995, vendimi për mos përfshirjen e çështjes së Kosovës në bisedimet e Dejtonit, lëkundë stabilitetin e LDK-së. Zhgënjimi i thellë i shqiptarëve të organizuar përreth lëvizjeve majtiste, siç ishin Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK), Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK), filluan forcimin e një rryme të re të rezistencës, që u bë e njohur si Ushtria Çlirimtare e Kosovës

¹²⁰Komisioni i Pavarur Ndërkombëtarë për Kosovën (KPNK). Raporti për Kosovën: Konflikti, përgjigja ndërkombëtare, mësimet e marra. Oxford University Press, Oxford,(2000), fq 37.

¹²¹ Malcom, Op.cid. fq 334-336.

¹²²Kipred, op.cit.

¹²³ Malcom Op.cid, fq 349.

¹²⁴http://www.kipred.org/advCms/documents/93788_ToJ_alb.pdf

(UÇK). Shumë shqiptarë tashmë ishin të sigurt se rezistenca e bashkuar paqësore nuk do të sillte lirinë dhe që veprimi ushtarak ishte mundësia e vetme¹²⁵. Luftimet me policinë u shtuan dhe u përhapën në tërë vendin sapo serbët filluan sulmet vdekjeprurëse kundër fshatrave shqiptare, duke kryer mizori mbi civilët gjersa mundoheshin të zënë luftëtarët e UÇK-se. Lufta e Kosovës ishte një konflikt i armatosur në Kosovë që filloi më 28 Shkurt 1998, pas sulmit Jugosllav në fshatrat Likoshan dhe Qirez në Drenicë të Kosovës dhe zgjati deri me nënshkrimin e marrëveshjes së Kumanovës 9 Qershor 1999. Sipas rregullores së UNMIK nr. 2000/66 të datës 21 Dhjetor 2000, konflikti i armatosur në Kosovë vlerësohet të ketë ndodhur midis 27 Shkurtit 1998 dhe 20 Qershorit 1999. Diferenca prej 11 ditëve prej nënshkrimit të marrëveshjes së Kumanovës deri tek përfundimi i luftës është për arsye se forcat serbe janë tërhequr për 11 ditë rresht nëpër III zonat e ndryshme të Kosovës.¹²⁶

Dallimi mes konfliktit të armatosur dhe luftës?

Konflikti i armatosur ka karakter jo ndërkombëtar, përkatësisht ato janë konfliktet e armatosura brenda për brenda një shteti midis grupeve të ndryshme apo midis një grupi apo një pjesë të popullatës me shtetin kurse lufta ka karakter ndërkombëtarë dhe palët në luftë janë dy e më tepër shtete.

Lufta e Kosovës ka pas karakter:

- të brendshëm (konflikt i brendshëm)
- ndërkombëtar (fillimi i bombardimeve të NATO-së 24 Mars 1999)

Më 29 janar të vitit 1999, Grupi i Kontaktit vendosi të organizojë një Konferencë Paqe për Kosovën, e cila duhej të fillonte më 6 shkurt të vitit 1999 në Rambouillet (Francë). Pas negociatave të mundimshme, më 23 shkurt të vitit 1999, delegacioni shqiptar i Kosovës në parim miratoi Marrëveshjen e Paqes pas letrës së garancisë nga Sekretarja e Shtetit të SHBA, zonjës Albright, se pas tri viteve të zgjedhjes së përkohshme në Kosovë do të mund të mbahet referendumi për statusin përfundimtar. Sidoqoftë, marrëveshja mbeti të nënshkruhet pas dy javësh në Paris, pasi të jenë përfunduar konsultimet me strukturat komanduese të UÇK-se.

Si pasojë, më 19 mars të vitit 1999, në Paris u nënshkrua Marrëveshja për Paqe nga delegacioni i shqiptarëve të Kosovës. Në anën tjetër, marrëveshja nuk u miratua dhe nuk u nënshkrua nga

¹²⁵Blumi, Isa. Kufijtë etnik në Shoqërinë Demokratike të Kosovës: Karta identifikuese e KB-së, fq 224-226. Në: Bieber, Florian dhe Daskalovski, Zidas (Eds.), Të kuptuarit e luftës në Kosovë, Londër: Frank Cass, (2003).


¹²⁶<http://www.unmikonline.org/Pages/kumanovo.aspx>

përfaqësuesit Jugosllavë/Serbë. Për më tepër, përpjekjet e të dërguarit të atëhershëm të SHBA, z. Richard Holbrook për të arritur një ujdi me z. Millosheviq përfundimisht dështuan më 23 mars të vitit 1999. Menjëherë pastaj Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s i asaj kohe, z.Javier Solana, urdhëroi sulmet e NATO-s kundër Jugosllavisë, të cilat filluan më 24 mars të vitit 1999. Në javët e para të fushatës ajrore të NATO-s situata në Kosovë ndryshoi në mënyrë dramatike. Më shumë se 850,000 Shqiptarë u detyruan të lëshojnë Kosovën, përderisa gati gjysmë milioni ishin të zhvendosur përbrenda Kosovës. Serbia praktikisht bëri spastrim etnik të Kosovës. UÇK nuk ishte në gjendje të mbronte popullatën. Për më tepër, për shkak të mungesës së ushqimit dhe strehimit për të zhvendosurit. Ndërkohë, vrasjet masive nga forcat Serbe ndodhnin në baza ditore, me një mesatare prej 250 viktimave në ditë¹²⁷.

Sulmet ajrore të NATO-s mbi Serbinë zgjatën 78 ditë, deri më 9 qershor 1999, kur Millosheviq u dorëzua dhe i tërhoqi të gjitha trupat serbe. Po atë ditë, Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën 1244, duke vendosur protektoratin ndërkombëtar mbi Kosovën. Konflikti i armatosur në Kosovë ka zgjatur nga 28 shkurti 1998 (kur në fshatrat Likoshan dhe Qirez janë vrarë 14 shqiptarë) deri te nënshkrimi i Marrëveshjes Ushtarake-Teknike më 9 qershor 1999 nga ana e NATO-së dhe Qeverisë së Republikës Federative të Jugosllavisë.

4.2.1 Statistikat

Grafiku i vrasjeve gjatë periudhës 01.01.1998-31.12.1998¹²⁸



¹²⁷Instituti për Raportimin e Luftës dhe paqës (IRLP).Loja me numrat në Kosovë.Raporti për krizën Ballkanike nr 92, 12.11.999, fq 23.

¹²⁸ Grafiku i vrasjeve gjatë periudhës 01.01.1998-31.12.1998 mundësuar nga http://www.kosovomemorybook.org/?page_id=46&lang=de

Lufta është një konflikt i armatosur, që zhvillohet midis sundimtarëve dhe duhet të jetë e drejtë. Krimet Kunder njerëzimit kryhen gjatë kohës së luftës ose gjatë kohës së pushtimit të territoreve të caktuara. Lufta e Kosovës filloi me 28 shkurt 1998, pas sulmit Jugosllav në Fshatrat Likoshan dhe Qirez në Drenicë të Kosovës, deri në 11 qershor 1999. Lufta u zhvillua mes forcave të Republikës Federale të Jugosllavis dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Në luftë u dëbuan 800,000 shiptarë nga territoret e tyre, u vranë 15,000 persona nga të cilët 2,400 luftar të UÇK-së, të tjeret banorë të thjeshtë.

Gjatë luftës janë zhdukur rreth 5,000 njerëz, fati shumicës prej tyre është zbardhur deri vitin 2007, por i madh ka mbetur numri i rasteve të pasqaruara.

Si krime kundër njerëzimit janë konsideruar:

- Vepra ç'njerëzore
- Tortura
- Përdhunimi
- Plaçkitja
- Masakrimi
- Vrasja dhe shfarrosja
- Dëbimi.

Krimi serb mbi popullatën shqiptare të Kosovës nuk kishte të ndalur, ata nuk sakrifkuan askënd, shkatruan çdo gjë të gjalle, çdo gjë që kishin dhe shihnin për rreth. Masakruan e vritën pleqë, fëmijë, gra shtatzën, mbyten kafshë, shkatëruan tërë token, dogjën gjitha shtëpitë.¹²⁹ Masakrat ishin të planifikuara, kishte raste, kur forcat, sidomos vullnetarët e paraushtarakët, dolën jashtë kontrollit, grabisnin, plaçkisnin e të vrisnin të pafajshëm. Masakrat në Thënie të dëshmitarëve bëjnë fjalë për tre motive masakrash.

1. I pari ish për t'i hapur rrugë procesit të "spastrimit"
2. I pari ish për t'i hapur rrugë procesit të "spastrimit"

Në këto kohë ish një gjë e zakonshme që forcat e sigurimit të bombardonin një fshat, pastaj të hynin në të dhe të urdhëronin popullsinë shqiptare të largohej. Disa vetë mund të jenë vranë për të mbejllë panik dhe për të përshpejtuar deportimin. Motivi i dytë ishte goditja e individëve të

¹²⁹ "Europe Kosovo rebels to disarm". BBC News. 1999-06-21. Marrë më 2012-11-08

dyshuar si pjesëmarrës apo si të lidhur me UÇK në.¹³⁰ Fshat pas fshati, forcat e sigurimit veçonin burrat nga gratë e fëmijët, dhe merrnin në pyetje burrat lidhur me kryengritjen, në ndonjë rast edhe duke i paraburgosur ata për disa ditë. Siç e konfirmojnë intervistat me dëshmitarë të mbetur gjallë, ashtu si edhe deklaratat e lëshuara nga forcat serbe e jugosllave pas luftës në median ndërkombëtare, burra të dyshuar për lidhje me UÇK-në vriteshin aty për aty. Një dyshim i tillë mund të bazohet ndonjëherë thjesht tek fakti, që dikush kish moshën e një luftëtari.

4.2.2 Aktakuzat ndaj Udhëheqësve Serb (Kosovë, Kroaci, Bosnj dhe Hercegovinë)

a) Slobodan Milosevic¹³¹

Prokurori I GJPNJ akuzon Slobodan Millosheviqin me tri aktakuza te ndara te cilat sipas dhomes se apelit te GJPNJ duhet te konsiderohen si nje Aktakuza e vetme.Krimet për të cilat akuzohet (shembuj):

b) Kosovë

Aktakuza e parë kundër Slobodan Millosheviqit, Millan Milutinoviqit, Nikolla Shainoviqit, Dragolub Ojdaniqit dhe Vlajko Stojiljkoviqit (lënda. IT-99-37), në lidhje me krimet e kryera në Kosovë, u konfirmua më 24 maj 1999 dhe u bë publike më 27 maj 1999.

Kjo aktakuzë u ndryshua më 29 qershor 2001. Më 29 tetor 2001 Prokuroria paraqiti aktakuzën e ndryshuar për here të dytë. Më 5 shtator 2002, Dhoma Gjyqësore ndau procedurat gjyqësore kundër Slobodan Millosheviqit prej të akuzuarve të tjerë. Aktakuza në fuqi pohon se ndërmjet 1 janarit 1999 dhe 20 qershorit 1999, Slobodan Milosheviqi mori pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale (NPK) së bashku me një numër individësh të tjerë duke përfshirë Millan Milutinoviqin, Nikolla Shainoviqin, Dragolub Ojdaniqin, Vlajko Stojiljkoviqin dhe të tjerë të njohur dhe të panjohur.

Gjatë kësaj periudhe forcat e Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) dhe Serbisë, duke vepruar nën drejtimin, me nxitjen, ose me mbështetjen e NPK-së, kryen një fushatë terrori dhe dhune drejtuar kundër civilëve shqiptarë të Kosovës.

¹³⁰ "State-building in Kosovo. A plural policing perspective". Maklu. 5 February 2015. p. 53.

¹³¹ Cencich, John, (2013). The Devil's Garden: A War Crimes Investigator's Story, Washington, DC: Potomac Books.

Pohohet se qëllimi i NPK-së ishte dëbimi nga Kosova i një pjese thelbësore të popullsisë shqiptare të Kosovës, me qëllim që të sigurohej vashdimi i kontrollit serb mbi krahinën. Millosheviqi mban përgjegjësi individuale për krimet e deklaruara kundër tij, në bazë të Neni 7(1) të Statutit të Tribunalit, dhe për krimet ose mosveprimet e vartësve të tyre, në bazë të Neni 7(3) të Statutit. Sipas aktakuzës, gjatë periudhës në fjalë, Slllobodan Millosheviqi ishte Kryetar i RFJ-së, Kryetar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes së RFJ-së dhe Komandant Suprem i Ushtrisë Jugosllave, (UJ). Në përputhje me pozitën e tij ai ushtroi autoritet komandues mbi UJ-në dhe forcat e policisë në vartësi të UJ-së. Përveç pushtetit të tij de jure, ai gjithashtu ushtroi kontroll de facto mbi institucione të shumta kyçe ose të përfshira në kryerjen e krimeve të deklaruara në aktakuzë. Më tej thuhet se përafërsisht 800.000 civilë shqiptarë të Kosovës u dëbuan nga krahina duke i larguar me forcë dhe duke plaçkitur dhe shkatëruar shtëpitë e tyre ose duke granatuar fshatrat. Gjatë këtij procesi shumë u vranë dhe u keqtrajtuat dhe iu vodhën të mirat materiale dhe dokumentet e identifikimit¹³².

Në bazë të përgjegjësisë individuale penale (Neni 7(1) i Statutit të Tribunalit), dhe në bazë të përgjegjësisë penale të eprorit (Neni 7(3) i Statutit), Slllobodan Millosheviqi u akuzua për:

- Dëbim; vrasje; përndjekje mbi baza politike, racore ose fetare; dhe veprime të tjera çnjerëzore/zhvendosje me forcë (**krime kundër njerëzimit, Neni 5**),
- Vrasje (shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, Neni 3).

4.2.3 Masakra e Reçakut

Masakra e Reçakut ose operacioni i Reçakut ishte vrasja masive e 45 shqipëtarëve. Masakra e Reçakut ose operacioni i Reçakut ishte vrasja masive e 45 shqipëtarëve që u zhvillua në fshatin Raçak në qendër të Kosovës në janar 1999.¹³³ 15 janari i 1999 shënon masakrimin e 45 shqiptarëve të pafajshëm të fshatit të Raçakut, përfshirë edhe 8 pjestarë të UCK. Serbia e sulmoi Kosovën për ta pushtuar duke synuar zhbërjen e një populli të tërë dhe spastrim etnik të saj, duke bërë krime e gjenocid të pashembullt mbi popullin shqiptar të Kosovës. Edhe pse Serbia ishte nxitëse e luftës për gati një dekadë, lau në gjak gjithë hapsirën e ish-Jugosllavisë duke i

¹³²http://www.icty.org/x/cases/slobodan_milosevic/cis/sq/cis_milosevic_slobodan.pdf

¹³³ Under Orders (Human Rights Watch)". Hrw.org. Retrieved 2013-02-05.

shkaktuar katër luftëra gjenocidiale. Shumë kohë para së Recaku të ndodhte, në Kosovë ishin debuar mijëra shqiptarë nga shtëpitë e tyre dhe qindra të tjerë ishin vrarë apo ekzekutuar. Me Recakun u rikthyen imazhet e masakrave serbe në Bosnjë e Hercegovinë. Shkaktari i Racekës ishte Milloshevic i cili më pas i shpëtoi Gjykatës së Hagës duke manipuluar kështu një pjesë të sistemit të drejtësisë në atë kohë. Masakra u nxit nga prania e aktivitetit separatist shqiptar në rajon, dhe u krye nga forcat serbe të sigurisë. Në planin diplomatik kishte ndryshime të mëdha në favor të Kosovës, sepse ajo kishte hyrë në agjendën e politikave ndërkombëtare falë luftës së pakompromis të UÇK-së në këto ingranazhe, dhe kur shumë diplomatë pritnin që të arrihej ndonjë marrëveshje, në mes të muajit janar ndodhi masakra e Reçakut që tronditi botën. Masakrohen 45 civilë shqiptarë moshash të ndryshme.¹³⁴ Ngjarjen e ndriçoi udhëheqësi i Misionit Verifikues, Villiam Vokër, i cili këtë ngjarje tragjike e quajti masakër të forcave serbe mbi civilët e paarmatosur, për çka si kundërpërgjigje Voker u shpall *persona non grata*. Në orët e hershme të mëngjesit të datës 15 janar 1999 ashtu siç ishte planifikuar në Beograd, fshati Reçak u zgjua i rrethuar nga formacionet e policisë speciale, militare dhe paramilitare serbe të shoqëruar edhe me mjete të shumta të motorizuara. Sipas dëshmitarëve që kanë mbijetuar krimin, aty rreth orës 6.30 minuta forcat serbe me artileri të rëndë kanë filluar të granatojnë fshatin, prej vendeve të quajtura „Pishat“, „Gështenjat“, „Rrasa e Çallakut“ dhe nga „Çesta“ përmbi Reçak¹³⁵. Pas ndërprejes së granatimeve forcat kriminale serbe janë futur në fshat dhe kanë filluar bastisjet shtëpi për shtëpi.¹³⁶ Forcat policore serbe që ishin futur përmes rrugës kryesore të fshatit kishin arrestuar në oborrin e shtëpisë (afër xhamisë) Banush Azem Kamberin, ndërsa familja e tij pak kohë më herët kishte braktisur shtëpinë. Forcat kriminale, Banushin pasi e maltretojnë fizikisht e ekzekutojnë me rafale automatiku në oborrin e fqit të tij Rashit Rashiti. Këta barbarë të mesjetës, nuk e lënë me kaq, pas ekzekutimit Banushit ia këpusin edhe kokën, e cila nuk është gjetur dot në vendin e krimit. Në masakrën e Reçakut, Sipas dëshmitarëve që kanë mbetur gjallë, kriminelët serbë pasi i kanë legjitimuar burrat e zënë, i kanë shtri për toke dhe kanë filluar t'i rrahin mizorisht duke përdorur kondakët e armëve, shqelmat, dru, zinxhirë dhe gjësende tjera të forta.

¹³⁴ Sylë Arifi, Shteti i Kosovës kontribut i shumë brezave. Prishtinë, 2009, faqe 89.

¹³⁵ "Masakra e Reçakut, ngjarja që bëri botën të kthejë kokën nga Kosova". Radio Televizioni Shqiptar. 15 janar 2019. Marrë më 20 dhjetor 2019.

4.2.4 Masakra e Deçanit

Në planin diplomatik kishte ndryshime të mëdha në favor të Kosovës, sepse ajo kishte hyrë në agjendën e politikave ndërkombëtare falë luftës së pakompromis të UÇK-së në këto ingranazhe, dhe kur shumë diplomatë pritnin që të arrihej ndonjë marrëveshje, në mes të muajit janar ndodhi masakra e Reçakut që tronditi botën. Masakrohen 45 civilë shqiptarë moshash të ndryshme. Ngjarjen e ndriçoi udhëheqësi i Misionit Verifikues, Villiam Vokër, i cili këtë ngjarje tragjike e quajti masakër të forcave serbe mbi civilët e paarmatosur, për çka si kundërpërgjigje Voker u shpall *persona non grata*.¹³⁷ Belegu është një fshat me histori të lashtë, shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës rreth 2 km në verilindje të Deçanit. Ashtu siç e dëshmojnë dokumentet arkivore, edhe pse jo të shumta në numër, mund të konsiderojmë se Belegu si lokalitet të populluar edhe pse me një popullsi shumë të vogël në krahasim me territorin dhe shtrirjen e tij, e hasim në Krisobulën e Deçanit që në vitin 1330.¹³⁸

Në defterin kadastral të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 janë regjistruar vojnukët e fshatit Beleg që bëjnë pjesë në Nahijen e Pejës. Në defterin hollësishtë të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1582 i varur nga Peja, është regjistruar si vendbanim me 27 shtëpi, 6 beqarë dhe 12 bashтина. Banorët e më hershëm të Belegut janë Hatashët të cilët janë shpërngulur ndërsa një prej tyre jeton në fshatin Leshan. Në fshat ekziston një tyrbe e njohur e kësaj ane, afër saj janë disa varreza të vjetra me shkrim arab dhe gurë të mëdhenj.¹³⁹

Belegu ashtu si të gjitha vendbanimet jo vetëm të Rrafshit të Dukagjinit por edhe në nivel të trojeve etnike shqiptare, e kishte fatin të përballej me luftëra dhe shpërngulje të banorëve si rezultat i shtypjes që vinte qoftë nga Perandoria Osmane apo edhe më vonë nga pushtuesit serbo-malazez, andaj për Belegun dhe banorët e tij ishte shumë sfiduese ruajtja e identitetit dhe vazhdimësisë së përkatësisë etnike shqiptare.

Belegu dhe shumë fshatra të Rrafshit të Dukagjinit, si dhe të tërë Kosovës, që nga viti 1912 pothuajse në vazhdimësi iu nënshtuan dhunës dhe terrorit serb.

¹³⁷ Sylë Arifi, Shteti i Kosovës kontribut i shumë brezave. Prishtinë, 2009, faqe 89.

¹³⁸ Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, Peja dhe Deçani, Prishtinë, 2004, faqe 266.

¹³⁹ Po aty

Në një raport të muajit korrik 1919, thuhet ndër të tjera se shovinistët malazez dogjën 598 shtëpi në fshatrat Jabllanicë, Raushiq, Strellc, Isnig, Deçan, Carrabreg, Llukë, Beleg, Perlep.¹⁴⁰ Viti 1919 është ndër vitet më të përgjakshme nën robërinë serbe. Vetëm gjatë dy muajve janar-shkurt, në Vilajetin e Kosovës u vranë 12.370 veta dhe u dogjën 6.100 shtëpi.¹⁴¹

Po ashtu burimet e tjera statistikore tregojnë shkatërrimet dhe krimet jo vetëm materiale, por edhe në njerëz të shkaktuara nga forcat serbe, duke vranë mbi 30.000 veta, kanë djegur 168 fshatra me 4869 shtëpi e një shumicë të madhe shqiptare, e kanë detyruar për t'u shpërngulur nga shtëpitë e tyre, thuhet në një raport të Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës dhe të Dibrës.¹⁴² Ashtu siç dëshmojnë të dhënat e mësipërme, shohim që Belegu jo vetëm që ka qenë i demoluar tërësisht disa herë nga pushtuesit, por gjatë gjithë kohës banorët e fshatit Beleg kanë qenë të detyruar edhe të shpërngulen për në vendet e largëta brenda dhe jashtë shtetit shqiptar. Kështu si pasojë e regjimit dhe politikës shoviniste serbe pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, një familje e Tahirajve, pas vitit 1946 është shpërngulur në Lushnjë të Shqipërisë, kurse familja e Molliqëve në Lubjanë të Sllovenisë.¹⁴³ Në marsin e vitit 1999, kohën kur sapo kishte filluar fushata e bombardimeve të NATO-s mbi caqet serbe, makineria dhe njësitet paralimitare çetnikeserbe kishin intensifikuar dhunën, terrorin dhe po përdornin të gjitha mjetet më çnjerëzore mbi popullatën civile shqiptare duke vranë masakruar pa mëshirë njerëz të pafajshëm në të gjitha anët e Kosovës.

Forcat ushtarake serbe me njësitet paramilitare duke mos qenë në gjendjetë përballen drejtpërdrejt me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe me forcat ndërkombëtare të Aleancës së NATO-s, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, po i vërsuleshin masës së pambrojtur shqiptare, masakrat dhe gjenocidi serb mbi popullatën shqiptare ishin bërë të përditshëm për forcat dirigjuara nga diktatori famëkeq Slobodan Millosheviq.

Më 29 mars 1999, njësitet e njëjta të forcave paramilitare serbe, para se të hynin në Beleg kishin vranë këta persona në fshatin Irzniq të Deçanit. Ekspedita serbe ndër ta polici Zoran Gjurishiq, ekzekutuan vëllezërit Himë (Dervish) Dervishaj dhe Tahir (Dervish) Dervishaj, aty rrëmbyen edhe vëllezërit tjerë Hajdar (Smajl) Daci (1941) e Tahir (Smajl) Daci (1936). Atë ditë policët serb ekzekutuan plakun Hajdin Dervishaj (1927) si dhe Zeqë (Isuf) Dervishaj (1933). Në të

¹⁴⁰ Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, Peja dhe Deçani, Prishtinë, 2004, faqe 267.

¹⁴¹ Po aty.

¹⁴² Arkivi Qendror Shtetëror i RPSH.

¹⁴³ Shënime të marra nga Sadri Binakaj (1922-2006), më 15.6.2004.

njëjtën ditë makineria serbe kishte zbrazur plumba pa mëshirë në turmën me gra, fëmijë e pleq, ku mbeti e vrarë në vendin e ngjarjes Shkurte Dervishaj (1955), nëna e dëshmorit Gëzim (Shaban) Dervishaj.¹⁴⁴ Fatin ogurzi të përjetonte një nga skenat më të tmerrshme të luftës së fundit në Kosovë e kishte edhe fshati Beleg. Më datë 29 dhe 30 mars 1999, Belegu u pushtua nga njësitet paramilitare serbe që vranë në prag të shtëpisë para familjarëve: Nezir e Naim Vishajn si dhe mësuesin nga Irzniqi Daut Aliçkajn, më pastaj popullatën civile i mblodhën në një shtëpi në qendër të fshatit duke i maltretuar e kërcënuar se do të vriteshin tash a tash. Në mëngjesin e 30 marsit 1999 forcat serbe, duke i rrahur ekeqtrajtuar gra, fëmijë e pleq i kishin deportuar me forcë drejt Shqipërisë, ndërsa burrat e mbase disa ende pa mbushur të tetëmbëdhjetat i ndalën aty për t'i pushkatuar më vonë të gjithë.

Më 29 mars 1999 ka ndodhur Masakra e Belegut, ku janë vrarë masakruar në mënyrën më barbare 46 civilë shqiptarë. Edhe pse janë bërë përpjekje të vazhdueshme qoftë nga familjarët e të zhdukurve apo nga institucionet për gjetjen e të zhdukurve, por prapë se prapë shumica dërmuese e të rënëve në masakër, mbesin ende të zhdukur, tani e shtatëmbëdhjetë vite nga momenti i masakrës.

Ndonëse dihen emrat e krimineleve që vranë masakruan banorët e fshatit Beleg, ende nuk ka ndonjë veprim konkret nga autoritetet serbe apo ato ndërkombëtare për dënimin autorëve të krimit në Masakrën e Belegut.

Sipas dëshmive të shumta, dhënë nga dëshmitarë edhe Prokurorisë së Tribunalit të Hagës, në masakrën e Belegut që është një nga masakrat më të tmerrshme, mori pjesë policia, ushtria e rregullt dhe paramilitarët serbë, me të gjitha pajisjet ushtarako-policore, tanke, blindat, praga, kamionë, pizgauerë. Ata që e mbijetuan këtë masakër, në dëshmitë të tyre dhënë Tribunalit të Hagës, ICG, KMDLNJ-së etj., kanë dhënë emrat e atyre që kanë marrë pjesë në masakër në Beleg, të atyre që i kanë njohur si: Vukmir (Mitar) Mirçiq, kryeshef i MUP-it të Deçanit, Zoran (Millorad) Nikiç (1957) nga Dashninoci, komandant i stacionit policor të MUP-it në Deçan, Zoran (Momçilo) Gjurishiq (1966) nga Prapaqani, me herët polic komunikacioni në Deçan, Danilo (Momqillo) Gjurishiq (1965) nga Prapaqani, Sllavko Llaban nga Prapaqani, Daniell Stomatoviç, elektrikist nga Prejlepi, Dejani që ka punuar të pasaportat, Jova Zeçeviq, Ratka Zeçeviq e Lubo (Jovan) Zeçeviq (1961) nga Drenoci (më herët shofer në shtëpinë e shëndetit në

¹⁴⁴Fetnete Ramosaj, Krimet serbe në Kosovë: pa apologji 2, me fakte kundër shpifjeve, Anatema, Prishtinë, 2008, faqe 197-198.

Deçan), polici Pero (Jovan) Zeçeviq (1967) nga Drenoci, Dushan Zeçoviq, Dragan Siniq, Dushan Knezheviq, kriminel luftime në Bosnjë Hercegovinë dhe në Kroaci, djemtë e Mushk Jakupit-Muharrem e Isuf Ibraj nga fshati Osek Hylë i Gjakovës etj.¹⁴⁵

Polici Zoran Gjurišiq, në hyrje të shtëpisë së Naim Vishajt në Beleg e kishte vrarë nga afërsia mësuesin Daut (Murat) Aliçkaj (1949), pak më tutje kishin ekzekutuar edhe Naim Vishaj¹⁴⁶ dhe Nezir Vishajn.

Më 30 mars 1999, tërë banorët jo vetëm të Belegut po edhe të fshatrave tjera ishin detyruar me dhunë të shpërngulën për në Shqipëri, ndërsa 46 burrat në mesin e tyre kishte edhe adoleshent në moshë të njomë si Faton Vishaj e Hasan Mazrekaj, u ekzekutuan më pas dhe që nga ajo ditë nuk dihet asgjë për fatin e shumicës prej tyre. Masakra e Belegut është njëra ndër krimet më të tmerrshme të kryera nga regjimi serb, gjatë luftës së viteve 1998-1999. Belegu, ashtu siç e dëshmojnë të dhënat në faqet paraprake në libër është një vendbanim i lashtë, me një histori të dhimbshme dhe në të njëjtën kohë krenare.

Fshati Beleg, gjatë tërë proceseve dhe sfidave që ka kaluar në përgjithësi kombi shqiptar përgjatë historisë, ka dhënë kontribut të çmueshëm në luftën për liri dhe pavarësi të vendit. Këtë e dëshmojnë fillet e organizimeve ushtarake në vitet '90, së bashku me komandantin Adem Jashari, ishin edhe shumë djem të Belegut, të bashkuar në kauzën legjitime për çlirimin e vendit. Belegu, para se të përjetonte njërin ndër episodet më të llahtarshme të tmerrit në Kosovë, ishte pushtuar viteve 1990-1991 nga qindra forca paramilitare serbe në kërkim të gjurmëve të grupit të parë ilegal që iu kishte bashkuar për mobilizimin e fshatit dhe rajonit për organizimin e luftës çlirimtare. Vitet 1998-1999 ishin të kobshme për Kosovën, e shumë të zeza për banorët e Belegut, të cilët ishin rreshtuar në istikame në pjesën hyrëse të fshatit për të mbrojtur popullatën civile të kësaj ane. Sigurisht që nuk ishte e rastësishme Masakra e Belegut, e ndodhur më 29 dhe 30 mars të vitit 1999, forcat serbe e dinin saktë vendin ku po hakmerreshin. Njësitë paramilitare serbe, pjesëtarët e të cilave, tanimë dihen me emra dhe mbiemra ekzekutuan 46 civilë shqiptarë në Beleg të Deçanit. Emrat e 46 të rënëve në Masakrën e Belegut, së bashku me nga një biografi të shkurtër janë të renditur, si dëshmi që kujtesa jonë kolektive si komb mund të na tradhtojë, e kjo asesi nuk guxon të na ndodhë.

¹⁴⁵ Fetnete Ramosaj, Krimet serbe në Kosovë: pa apologji 2 me fakte kundër shpifjeve, Anatema, Prishtinë, 2008, faqe 200.

¹⁴⁶ Po aty.

c) Kroaci

Përndjekje mbi baza politike, racore ose fetare; shfarosje; vrasje; burgosje; torturë; veprime çnjerëzore; dëbim; veprime çnjerëzore (zhvendosje me forcë) (**krime kundër njerëzimit**, Neni 5),

Vrasje të qëllimshme; heqje të paligjshme e lirisë; torturë; shkaktim të qëllimshëm të vuajtjeve të mëdha; dëbim ose zhvendosje të paligjshme; shkatërrim të gjerë dhe përvetësim të pronës të pajustificuar nga domosdoshmëria ushtarake dhe kryer në mënyrë të paligjshme dhe pa arsye (shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, Neni 2), Vrasje; torturë; trajtim mizor; shkatërrim pa arsye të fshatrave, ose shkatërrim të madh i pajustificuar nga domosdoshmëria ushtarake; shkatërrim ose dëmtim të qëllimshëm të institucioneve arsimore ose fetare; plaçkitje të pronës private ose publike; sulme kundër civilëve; shkatërrim ose dëmtim pa arsye të monumenteve historike dhe institucioneve arsimore ose fetare; sulme të paligjshme mbi objekte civile (shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, Neni 3).

d) Bosnja dhe Hercegovina

Gjenocid; bashkëpunim në gjenocid (gjenocid, Neni 4), Përndjekje mbi baza politike, racore ose fetare; shfarosje; vrasje; burgosje; torturë; dëbim; veprime çnjerëzore; dhe zhvendosje me forcë (krime kundër njerëzimit, Neni 5),

Vrasje të qëllimshme; heqje të paligjshme të lirisë; torturë; shkaktim të qëllimshëm të vuajtjeve të mëdha; dëbim ose zhvendosje të paligjshme; dhe shkatërrimtëi gjerë dhe përvetësim të pronës (shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, Neni 2),

Vrasje; torturë; trajtim mizor; shkatërrim pa arsye të fshatrave, ose shkatërrim të madh i pajustificuar nga domosdoshmëria ushtarake; shkatërrim ose dëmtim të qëllimshëm të institucioneve arsimore ose fetare; plaçkitje të pronës private ose publike; sulme kundër civilëve (shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, Neni 3).

4.3 Historiku i gjenocidit ndaj Muslimanve Bosnjak 1683-1699

Ashtu siç Evropa kryqëtare-inkuizitore gjatë periudhës, pothuajse dyshekullore (1099-1271) udhëhoqi dhjetë kryqëzata-plaçkitëse kundër botës islame dhe myslimanëve, të njëjtën gjë po e njëjta Evropë do ta lejojë në hapësirat e ish Jugosllavisë kundër boshnjakëve dhe shqiptarëve. Historia nuk harroi pa shënua dhjetë gjenocidet të cilat u kryen ndaj boshnjakëve, mirëpo, nga të gjithë ato dhjetë gjenocide, ky i fundit (1992-1995) ishte me përmasa shumë më të tmerrshme dhe më shkatërrimtare, por u përcoll edhe me mbrojtjen e parë të organizuar nga një ushtri boshnjake.¹⁴⁷

Gjenocidi i parë ndaj Myslimanëve boshnjak ndodhi 584 vite pas kryqëzatave të para. Ky gjenocid zgjati prej vitit 1683 e deri në vitin 1699 dhe ishte gjenocidi dhe tragjedia e parë e madhe dhe kolektive ndaj myslimanëve që ndodhi gjatë dhe pas, të ashtuquajturës, Luftës së Madhe ose Luftës së Vjenës ndërmjet Perandorisë Osmane dhe Austro-Hungarisë. Pasi që Turqit në këtë luftë humbën pushtetin në Hungari, Sllavoni, Likë, Kërbavë, Dalmaci dhe në Grykën e Kotorit, të gjithë myslimanët e këtyre viseve të cilët nuk kishin mundësi të shpërngulen në kohë të caktuar në drejtim të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe në viset tjera në jug të Savës dhe Danubit, për një kohë të shkurtër, sikurse myslimanët e Spanjës para dy shekujve u mbytën, u persekutuan, u asimiluan ose u detyruan që me dhunë të konvertojnë në katolicizëm. Spiritus movens (Lëvizësi shpirtërorë) dhe fuqia kryesore e të gjitha këtyre aksioneve antiislame ishte Kisha. Ajo bazohej në dogmat kishtarë extra ecclesiam nulla sallus (shpëtimi ekziston vetëm në kishë, e assesi jashtë saj) dhe extra ecclesiam nullus propheta (jashtë Kishës nuk ekziston profet-mirësi, drejtësi dhe lidhje të vërtetë me Zotin).¹⁴⁸ Ky është arsytimi krishter-religjioz i kryqëzatave, Inkuizicionit dhe gjenocidit ndaj të gjithë jokrishterëve. Myslimanët, si dhe të gjitha objektet e kulturës dhe qytetërimit islam nuk u kursyen as për gjashtëmbëdhjetë vite (1683-1699) nga dora e zullumqarëve të krishterë, e as që ka mundur t'i mbrojë dhe t'i shpëtojë fakti se ata (të krishterët) para kësaj kohe prej vitit 1526-1683 sa sunduan myslimanët në të njëjtat vise, i kishin të garantuara të gjitha të drejtat njerëzore, fetare, kulturore dhe pronësore. Në vend të falënderimit dhe tolerancës ndaj myslimanëve, të krishterët e këtyre viseve, në emër të “religjionit të dashurisë”, pazezervë dhe në mënyrë ekstreme ndaj tyre zbatuan parimin e vjetër

¹⁴⁷ Draft, Gjenocidi i dhjetë, Mbrojtja e pare, shkruar nga Behxhet Jashari, Bosnjën ashtu siç e duam, qasur me 11/01/2020.

¹⁴⁸ Po aty.

pagano-faraonik; “Cuius regio eius religio” (i kujt është pushteti, i atij është edhe religjioni). Sikurse ata të jenë krijues të Tokës, e jo Zoti! Nga e kaluara e myslimanëve në këto vise kanë mbetur vetëm disa toponime dhe mbiemra të ndryshme, si p.sh. Haxhiqi... Për gjenocidin e parë ndaj myslimanëve, më me rëndësi është të theksohet se kanë luftuar Turqia dhe Austria, kurse viktimë ishin Myslimanët-boshnjakë!¹⁴⁹

4.3.1 Gjenocidi i dytë ndaj Muslimanëve “shfarosje e turkoshakëve”1711

Gjenocidi i dytë ndaj myslimanëve ka ndodhur në fillim të shekullit XVIII, gjegjësisht në vitin 1711 në vigjiljen e natës së Kolendrave. Atë natë është zbatuar, e ashtuquajtura “shfarosje e turkoshakëve”. Në këtë natë, në viset e “Malit të Zi të vjetër” u persekutuan, u mbytën dhe u dëbuan disa mijëra myslimanë. Një numër i vogël nga ata u strehuan në Nikshiq dhe në fshatin Tuxhemile afër Tivarit. Strateg, promotor ideor dhe agens (fuqi nxitëse dhe lëvizëse) i gjenocidit të dytë ndaj myslimanëve, kësaj rradhe në zonën e Malit të Zi, përsëri ishte Kisha, në këtë rast jo katolike, por ajo ortodokse. Për këtë pohim ekzistojnë dy dëshmi të pamohueshme: e para është se “shfarosja e renegatëve turkoshakë”, në realitet gjenocidi ndaj myslimanëve është realizuar në vigjilje të Kolendrave “festës më të madhe dhe më të shndritshme krishtere” dhe dëshmia e dytë është se atë ngjarje ose “shfarosjen e renegatëve” e këndoi peshkopi më i lartë kishtar si dhe poeti i njohur Petar Petroviq Njegoshi në “Gorski vijenac”. Ai me këtë ofroi bazën epike të ideologjizuar dhe paradigmen për të gjitha gjenocidet e mëvonshme ndaj myslimanëve të Serbisë, Sanxhakut, Malit të Zi dhe të Bosnjë e Hercegovinës.¹⁵⁰

¹⁴⁹ Draft, Gjenocidi i dhjetë, Mbrojtja e pare, shkruar nga Behxhet Jashari, Bosnjën ashtu siç e duam, qasur me 11/01/2020.

¹⁵⁰ Po aty.

4.3.2 Gjenocidi i tretë ndaj Muslimanëve “shfarosje e përgjithshme e turqëve-muslimanëve nga populli” 1804-1820

Gjenocidi i tretë ndaj muslimanëve, të cilin diplomati dhe historiani i njohur serb Stojan Novković e emëroi si “shfarosje e përgjithshme e turqëve-muslimanëve nga populli”, ngjau në Serbi gjatë viteve (1804-1820). Për këtë gjenocid mund të thuhet se ishte pasojë e dy kryengritjeve serbe. Me fjalë të tjera, që nga fillimi i shekullit XIX, Serbia dhe Mali i Zi duke i dëbuar, persekutuar dhe shfarosë muslimanët dëshironin ta zgjeronin shtetin e tyre. Kështu që gjenocidi dhe shkatërrimi ndaj muslimanëve ishte qëllimi konstant dhe strategjik në politikën e Serbisë dhe Malit të Zi gjatë tërë shekullit XIX dhe XX. Pranë Kishës Ortodokse e cila që nga gjenocidi i dytë ka luajtur rolin kryesorë, në gjenocidin e tretë ndaj muslimanëve, kësaj kishe iu bashkëngjiten edhe historianët, politikanët dhe poetët të llojit të Njegoshit.¹⁵¹

4.3.3 Gjenocidi i Srebrenicës 1995

Gjenocidi i Srebrenicës ose Tragjedia e Bosnjës¹⁵² është një krim lufte i zbatuar në korrik të vitit 1995 në Bosnje dhe Hercegovinë, ku u vranë më shumë se 8,000, boshnjakë muslimanë, kryesisht burra dhe djem të moshës 12 deri 77 vjet.¹⁵³ Gjenocidi në Srebrenicë ka ndodhur në korrik të vitit 1995 dhe nënkuptohet vrasja masive e planifikuar e një numri të madh të meshkujve dhe fëmijëve nga 12 deri në 77 vjet të boshnjakëve. Gjenocidi ka ndodhur në rajonin e Srebrenicës nga ushtria e Republikës Serbe nën komandën e Ratko Mladić dhe dhe formacionit ushtarak “*Skorpioni*”, nën kontrollin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. Kjo ngjarje shënon një nga masakrat më të mëdha pas Luftës së Dytë Botërore në Europë në të cilën janë vrarë 8.000 burra musliman. Masakra llogaritet të jenë një nga ngjarjet më makabër në historinë me të re të Evropës. Gjyqi Ndërkombëtar i Hagës ka marrë vendimin që masakra e Srebrenicës të kualifikohet si gjenocid.

¹⁵¹ Draft, Gjenocidi i dhjetë, Mbrojtja e parë, shkruar nga Behxhet Jashari, Bosnjën ashtu siç e duam, qasur me 11/01/2020.

¹⁵²“Potocari Memorial Center PRELIMINARY LIST of Missing Persons from Srebrenica '95”. Arkivuar nga origjinali origjinali më 18 prill 2014. Marrë më 11 korrik 2015.

¹⁵³ Facts about Srebrenica

Gjenocidi është zbatuar në rajonin e Srebrenicës nga Ushtria e Republikës Serbe (VRS) nën udhëheqjen e gjeneralit Ratko Mlladiq, duke përfshirë njësinë paraushtarake "Škorpioni" (*Akrepat*), e cila ishte pjesë e Ministrisë së punëve të brendshme të Serbisë, si dhe disa qindra vullnetarë grekë dhe ruse.¹⁵⁴

Bosnje dhe Hercegovina njihet me ngjarjen tragjike që njihet si "gjenocidi i Srebrenicës", ku humbën jetën mbi 8 mijë meshkuj boshnjakë të vrarë nga serbët. Krahas kësaj ky vend ka njohur edhe tragjedi të tjera të ngjashme si ajo e Sarajevës, Vishegradit, Prijedorit, Zvornikut, Foças apo Bijelinës. Boshnjakët kanë qenë preh e shumë dramave të ngjashme me atë të Srebrenicës. Bosnje dhe Hercegovina njihet me ngjarjen tragjike që njihet si "gjenocidi i Srebrenicës", ku humbën jetën mbi 8 mijë meshkuj boshnjakë të vrarë nga serbët. Krahas kësaj ky vend ka njohur edhe tragjedi të tjera të ngjashme si ajo e Sarajevës, Vishegradit, Prijedorit, Zvornikut, Foças, apo Bijelinës. Boshnjakët kanë qenë preh e shumë dramave të ngjashme me atë të Srebrenicës.

Bashkë me fillimin e copëtimit të ish Jugosllavisë më 29 shkurt, më 1 mars Bosnje Hercegovina përmes një referendumi shpalli pavarësinë, por bashkë me këtë referendum fillojë edhe një luftë e cila zgjati deri në vitin 1995, luftë kjo që ishte nga më të përgjakshmet në historinë e këtij vendi. Në këtë luftë shumica boshnjakë rreth 100 mijë persona humbën jetën, afërsisht 50 mijë gra u përdhunuan dhe rreth 2 milionë njerëz u detyruan të lënë shtëpitë e tyre.

¹⁵⁴ Williams, Daniel. "Srebrenica Video Vindicates Long Pursuit by Serb Activist". The Washington Post. Marrë më 26 dhjetor 2020.

PËRFUNDIMI

Konkluzionet dhe rekomandimet kanë rëndësi të veçantë në një punim. Krimet kundër njerëzimit u bënë të njohura fillimisht nga Deklarata E Forcave Aleate (Rusia, Franca dhe Britania). Fill pas Luftës së Dytë Botërore holokhausti ndaj hebrenjëve çoj në domosdoshmërinë e ndëshkimit të kriminelëve të luftës. Statuti i Tribunalit të Nurembergut përbën dhe kodifikimin e parë të krimeve kundër njerëzimit. Në të gjithë tribunalet qëllimi, elementët kriminalë dhe aktet ishin pothuajse të njëjta. Gjithashtu nuk kishte përjashtime nga përgjegjësia penale pavarisht funksionit të akuzuarit, njëhej parimi i Universalitetit dhe Supremacisë së tribunalit. Këshilli i Sigurimit vendosi të themelojë dy tribunalet ai i Hagës dhe I Ruandës si një masë të miratuar sipas Kreut VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, ndërsa Tribunali në Sierra Leone u arrit me marrëveshje mes qeverisë dhe OKB-së. Më 17 korrik 1998, pas tre vitesh diskutimi dhe një sesi negociues pesë javor, qeveritë e mbledhura për përfundimin e konferencës diplomatike në Romë votuan për krijimin e një Gjykate Penale Ndërkombëtare të Përhershme, me seli në Hagë. Ky statut është kompetente për genocide, krime kundër njerëzimit, krimet e agresionit dhe krimet e luftës. Sot Statuti i Romës përbën dhe legjislacionin në fuqi për të dënuar krimet ndërkombëtare. Vitet e para pas rënies së komunizmit shteti shqiptar i kushtoi një rëndësi të madh legjislacionit rreth krimeve kundër njerëzimit. Këtu përmendim dhe faktin që Shqipëria aderon në të gjitha konventat dhe statutet ndërkombëtare për luftimin dhe parandalimin e fenomenit si Statuti i Romës, Konventa e Gjenevës dhe protokollet shtesë etj. Pas firmosjes së Statutit të Romës, u vërenjt nga legjislatori se vepra duhej të formulohej plotësisht sipas modelit frances dhe atij të Tribunalit të Nurembergut. Statuti i Romës për GJPN, i ratifikuar me ligjin nr.8994, të 23 dhjetorit 2002, është pjesë e sistemit ligjor shqiptar dhe ka superioritet mbi ligjet e vendit që nuk janë në përputhje me të. Forma e implementimit është mos-implementimi i plotë dhe aplikimi i legjislacionit vendas. Sipas Statutit të Romës kuptojmë që legjislatori ka vënë disa kushte që duhet të plotësohen para se vepra penale të konsiderohet krim kundër njerëzimit. Këto paraqiten në paragrafin e parë dhe të dytë të nenit dhe janë: ekzistenca e sulmit dhe e një politike shtetërore ose organizative, sulmi duhet të jetë i gjerë ose sistematik, të drejtohet kundër popullsisë civile, lidhja ndërmjet sjelljes së kryerësit dhe sulmit, si dhe duhet të ekzistojë dijenia

e kryerësit me qëllimin e veprës penale. Ndryshimet me statutin e bëjnë ndryshimin e nenit 74 një domosdoshmëri për ta harmonizuar atë me përcaktimin e statut të GJNP-së.

Legjislacioni francez e ka përafuar veprën penale të Krimeve kundër njerëzimit me Statutin e Romës. Shprehet qartë se elementët që duhen janë po ato të shprehura në statut. E rëndësishme të përmendet është dhe se legjislatori francez nuk e njih juridiksionin universal për aktet që përbëjnë krime kundër njerëzimit. Modeli i implementimit që Franca ka ndërmarrë është ajo implementimit të përzier, sepse si figurë të veprës penale e ka implementuar tërësisht, ndërsa elementët përbërës të veprës i ka pranuar sipas legjislacionit të saj. ". Përkufizimi që jep Kodi Penal I Shqipërisë, megjithëse korrespondon në një masë të caktuar në nenin 212-1 të Kodit Penal Frances, është mjaft i kufizuar në aspekte të ndryshme. Në Kodin Shqiptar, kryerja e krimeve nuk kushtëzohet me ekzistencën e një konflikti të armatosur. Por nga ana tjetër, ajo bazohet në baza diskriminuese dhe nuk përfshin disa elemente të krimeve të tilla si veprat penale seksuale, krimi i aparteidit etj. Një ndryshim tjetër që shohim janë dënimet, Franca prerazi ka dhënë dënimin maksimal (burgim i përjetshëm), ndërsa Shqipëria e ka vënë dënimin në varësi të bindjes së gjykatës nga 15 vjet në burgim të përjetshëm.

Gjermania ratifikoi Statutin e Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale më 11 dhjetor 2000. Akti që ndryshon nenin 16 të Ligjit Themelor ka krijuar bazën kushtetuese duke bërë të mundur që Gjermania të dorëzojë gjermanët edhe në gjykatat ndërkombëtare, e kështu edhe në Gjykatën Ndërkombëtare Penale. Legjislatori gjerman ndryshe nga legjislatorët e tjerë, për krimet ndërkombëtare ka hartuar një kod të veçantë. Kodi "Për krimet kundër të drejtës ndërkombëtare". Dënimet fillojnë nga një vit deri në burgim të përjetshëm, kur nga aktet kanë ardhur pasoja të rënda.

Aktet kriminale të parashikuara për krimet kundër njerëzimit, në legjislacionin gjermanë janë më të përafërta me Statutin e GJNP-së, se aktet që përbëjnë krime kundër njerëzimit sipas nenit 74 të ligjit shqiptar. Theksi kryesor vihet tek dënimet, legjislatori gjerman dënimet i ka të ndryshme në funksion të pasojave që ato kanë sjellë dhe relativisht janë më të buta, se ato që parashikohen në nenit 74 të Kodit Penal Shqiptar. E përbashkëta qëndron që të dyja vendet e pranojnë juridiksionin e GJNP-së në territorin e tyre.

Krimet kundër njerëzimit nuk janë të kodifikuara në Itali. Shumica e krimeve të përfshira në nenin 7 të Statutit të Romës mbulohen pjesërisht nga dispozita penale vendase. Përsa i përket dënimeve për aktet që parashikohen në statut, sipas legjislacionit italian dënohen si krime të

veçanta, prsh vrasja ose kthimi në skllavëri sipas statutit, dënohet sipas parashikimeve të Kodit Penal Italian.

Nga analiza e legjislacionit Italian arsyetojmë që politika penale e ndjekur si nga Italia, ashtu dhe Shqipëria është po e njëjta. Asnjëra nga të dy shtetet nuk i ka kodifikuar krimet kundër njerëzimit. Dhe se dënimi, figura e veprës penale mbulohen nga legjislacioni vendas.

Rep e Kosovës nuk e ka ratifikuar statutin, në legjislacionin penal e ka kodifikuar tërësisht veprën penale të krimeve kundër njerëzimit sipas Statutit të Romës. Pra flasim për një para implementim të kopjuar.

Republika Polake e ratifikoi Statutin e Romës në 12 nëntor 2001, dhe e bëri pjesë te legjislacionit penal në vitin 2004. Në Kodin Penal u shtua kapitulli 66a që flet për marrëdhëniet midis Republikës Polake dhe GJNP-së. Neni 661 i Kodit pranon juridiksionin e GJNP-së dhe në paragrafin e dytë shprehet se në rastet e ndalimit, hetimit, gjykimit dhe dënimit të një individi brenda territorit polak duhet të merret leja nga Min. E Drejtësisë, e cila pasi verifikon rrethanat mund të pranoj dorëzimin ose jo të personit. Përsa i përket krimeve kundër njerëzimit legjislatori polak i ka bashkuar veprat kundër paqes, njerëzimit dhe veprave të Luftës në një nen të përbashkët. Shohim që legjislatori polak ka shtuar disa vepra penale më shumë se në statut. Nga analiza që i bëhet nenit 118 ndryshe nga statuti, krim kundër njerëzimit përbën dhe vrasja e një indivi të vetëm të një grupi kombëtar, etnik, racial, politik, fetar ose filozofike. Element tjetër cilësues që të kemi figurën e veprës penale, duhet që të ekzistojë qëllimi i shkatërrimit tërësisht ose pjesërisht të këtij grupi. Dënimet që parashikohen janë relativisht të lehta, përkatësisht nga 3 vjet-në burgim të përjetshëm. Kodi penal shqiptarë nuk e ka të shprehur qëllimin e shkatërrimit pjesërisht ose tërësisht dhe element shtesë ka planin e paramenduar ose kryerja e akteve në mënyrë sistematike. Aktet që përbëjnë krime kundër njerëzimit sipas legjislacionit shqiptarë janë më të pakta në numër. Forma e implementimit nga të dy vendet është e njëjta, mos-implementimi i plotë dhe aplikimi i legjislacionit vendas. Në të dy legjislacionet aktet mbulohen nga kodi penal vendas dhe jo nga statuti. Ligji për krime kundër njerëzimit është zhvilluar kryesisht si reagim ndaj rrethanave historike, specifike, lemerisëse e në mënyrë të veçantë nga Holokausti, spastrimi etnik në ish Jugosllavi dhe gjenocidi në Ruandë.

Bibliografia

I -Libra

1. Allan Thompson, Media dhe Genocidi i Ruandës, 2007
2. Ambroise Castérot, E drejta Penale Speciale, 2008
3. Andrew Bromhall, Gjykata ndërkombëtare penale, Format e implementimit nga shtetet, 2009
4. Christine Byron, Krimet e luftës dhe krimet kundër njerzimit në Statutin e Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale, 2009
5. Eve La Heya, Krimet e luftës në konfliktet e armatosura, 2008
6. Fetnete Ramosaj, Krimet serbe në Kosovë, pa apologji 2 me fakte kundër shpifjeve, Prishtinë, 2008
7. Gentile Alberico, De jure belli, Adolfo Mijaja de la Muela, introduccion al Derecho Internacional Publico, Madrid, 1979
8. Gerd Hankel, Inventari në të drejtën penale ndërkombëtare dhe gjykatat penale ndërkombëtare, 1995
9. Grup autorësh: Margaret De Guzman, Bartram S. Brown dhe Edgar Elgar, Research Handbook on International Criminal Law, 2011
10. Grup autorësh: Pradel Dubost, Ferry Cornsten dhe Mannens Vermulen, E drejta penale evropiane, 2010
11. Haki Kasumi, Djegiet e fshatrave dhe grabitjet e pronave toksore, Kosovë, 1996
12. Ismet Elezi, E drejta Penale (pjesa e posaçme), Tiranë, 2008
13. Ismet Elezi, E Drejta Penale e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2015
14. Ismet Elezi, E drejta penale: pjesa e Posaçme: azhornuar e plotësuar me shtesat e ndryshimet e bëra me reformat ligjore të viteve 2001-2013, Tiranë, 2014
15. Jared Genser dhe Bruno Stagno Ugarte, Këshilli i Sigurimit në epokën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, 2014
16. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës, Peja dhe Deçani, Prishtinë, 2004

17. Kathleen Malley-Morrison dhe Andrea Mercurio, Gabriel Twose, Libri i Paqes dhe pajtimit, 2004
18. Kevin Heller dhe Gerry Simpson, Historitë e fshehura të krimeve ndërkombëtare, 2013
19. Mahmoud Cherif Bassiouni, E drejta ndërkombëtare Penale, Cambridge, 2008
20. Mahmoud Cherif Bassiouni, Krimet kundër njerëzimit, Evolucioni dhe aplikimi ligjore, 2011
21. Robert Cryer, Prezantimi i të drejtës ndërkombëtare penale dhe procedures, 2003
22. Steven Powles, Praktika e penale ndërkombëtare, 2003
23. Sylë Arifi, Shteti i Kosovës kontribut i shumë brezave. Prishtinë, 2009
24. Von Bar, A history of continental criminal law, 2009
25. Williams, Daniel, Srbrenica video vindicates long pursuit by serb activist, 2011
26. Zejnullah Gruda, Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, 2007
27. Zvonimir Šeparović, Vitimologija, studija o žrtvama, 2001
28. Zvonimir Tomić, Nirnberška presuda, Sarajevo, Magistrat, 2001

II- Burime tjera

1. Agreement for the Prosecution and Punishment of the Major War Criminals of the European Axis, art. 6, 8 Aug. 1945, Annex, 59 Stat. 1544, 82 U.N.T.S. 279, reprinted in 39 AM. J. INT'L L. 257 ,hereinafter Nuremberg Charter, 1945
2. Blumi, Isa. Kufijtë etnik në Shoqërinë Demokratike të Kosovës: Karta identifikuese e KB-së, fq 224-226. Në: Bieber, Florian dhe Daskalovski, Zidas (Eds.), Të kuptuarit e luftës në Kosovë, Londër: Frank Cass, 2003
3. Burns, Peter, "Aspect of Crimes Against Humanity and the International Criminal Court" International Centre for Criminal Law Reform and Criminal Justice Policy
4. Declaration on the Need for a Comprehensive Convention on Crimes Against Humanity Whitney R. Harris World Law Institute

5. Dokument i përgatitur prej Shërbimit të Komunikimit. Të tëra dokumentet kryesore të TPNJ-së gjenden në: www.un.org/icty Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Churchillplein 1, 2517 JW The Hague, Netherlands.
6. Draft, Gjenocidi i dhjetë, Mbrojtja e parë, shkruar nga Behxhet Jashari, Bosnjën ashtu siç e duam, qasur me 11/01/2020.
7. Encklopedia e Luftës së II; Spencer Tucker, 2005
8. Gjenerali Trifunoviq: Nuk do të shkoj në gjykim”, faja e internetit Radio Evropa e Lirë, 14 korrik i vitit 2010.
http://www.slobodnaevropa.org/content/general_trifunovic_optuzen_za_ratni_zlocin_u_sloveniji/2099828.html
9. Instituti për Raportimin e Luftës dhe paqës (IRLP).Loja me numrat në Kosovë.Raporti për krizën Ballkanike nr 92, 12.11.999
10. Jasmina Pjanic (OKO lawyer), Joint Criminal Enterprise New form of individual criminal responsibility.
11. Karta Karta e Tokios
12. Komentari i Kodit të Proc. Penale të Francës 2000; Glibert Azibert
13. Komisioni i Pavarur Ndërkombëtarë për Kosovën (KPNK). Raporti për Kosovën: Konflikti, përgjigja ndërkombëtare, mësimet e marra. Oxford University Press, Oxford,(2000)
14. Konventa për parandalimin dhe dënimin e Genocidit
15. Masakra e Reçakut, ngjarja që bëri botën të kthejë kokën nga Kosova". Radio Televizioni Shqiptar. 15 janar 2019. Marrë më 20 dhjetor 2019.
16. Ndërkombëtare të Tribunaleve Ushtarakë
17. Potocari Memorial Center PRELIMINARY LIST of Missing Persons from Srebrenica '95". Arkivuar nga origjinali origjinali më 18 prill 2014. Marrë më 11 korrik 2015.Facts about Srebrenica
18. Progres Raporti i BE, 2014 “ Për Procesin e Integritimit në BE”
19. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, S/2009/169, 6 prill 2010, Shtojca I, pika 2. Policia. E qasur me 25 maj 2010 nga <http://www.un.org/Docs/sc/sgrep10.htm> e më pas në raporti i

6 prillit 2010. Për një përshkrim më të detajuar shih raportin e OSBE-së, Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kosovë; Shqyrtim. (shtator 2002). E qasur me 28 dhjetor 2020 në http://www.osce.org/documents/mik/2002/09/857_sq.pdf

20. Rastin Nr. IT-03-66-T, nga Gjykata Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë nga viti 1999, Prokurori kundër Limaj, Bala dhe Musliu, aktgjykimi i 30 nëntorit 2005, paragrafët 738-743. E qasur me 23 prill 2010 në <http://www.icty.org/x/cases/limaj/tjug/sq/051130.pdf>. Për ankesën shih Rastin Nr. IT-03-66-A, nga Gjykata Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë nga viti 1999, Prokurori kundër Limaj, Bala dhe Musliu, aktgjykimi i 27 shtatorit 2007, Pjesa Shtatë, Vendim. E qasur me 23 prill 2010 në <http://www.icty.org/x/cases/limaj/acjug/sq/070927.pdf>.
21. Rastin Nr. IT-04-84-T, nga Gjykata Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë nga viti 1999, Prokurori kundër Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj, aktgjykimi i 03 prillit 2008, paragrafët 502-505. E qasur me 23 prill 2010 në <http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/tjug/sq/080403.pdf>.
22. Shqyrtimi i parë i OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Penale në Kosovë (1 shkurt 2000 – 31 korrik 2000), Rasti Momcilovic: Raport i Përkohshëm.
23. Statuti i Gjykatë Speciale e Sierra Leone
24. Statuti i Nurembergut
25. Statuti i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë
26. Statuti i Tribunalit të Hagës
27. Statuti i Tribunalit të Ruandës
28. Zyra E Punëve të Jashtme Francë 24 Maj 1915, Deklarata për dënueshmërinë e akteve të ndërmarra nga Porta E Lartë në Armeni.

Web – Fage

1. <http://fl1.findlaw.com/news.findlaw.com/hdocs/docs/icty/miloseviccroatiaindtmt100801.pdf>
2. <http://www.icty.org/case/martic/4>
3. <http://www.icty.org/x/cases/babic/tjug/en/bab-sj040629e.pdf>
4. http://www.icty.org/x/cases/slobodan_milosevic/cis/sq/cis_milosevic_slobodan.pdf;
5. http://www.icty.org/x/cases/slobodan_milosevic/cis/sq/cis_milosevic_slobodan.pdf
6. http://www.icty.org/x/file/Legal%20Library/Statute/statute_sept09_en.pdf
7. http://www.kipred.org/advCms/documents/93788_ToJ_alb.pdf
8. http://www.kosovomemorybook.org/?page_id=46&lang=de.
9. http://www.oas.org/en/sla/dil/docs/NU_2142_XXI_eng.pdf; No. 2142 (XXI) -
Organization of American States
10. <http://www.un.org/press/en/2008/sc9364.doc.htm>
11. <http://www.unmikonline.org/Pages/kumanovo.aspx>
12. https://treaties.un.org/pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=IV-6&chapter=4&lang=en#3
13. https://treaties.un.org/pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=IV-6&chapter=4&lang=en#

III- Ligje, Kushtetuta

1. Kodi Penal i Republikës së Kosovës
2. Komentari i normave penale të dhunës seksuale dhe të pedofilisë; A. Cadoppi 2002
3. Konventa europiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese Teksti i Konventës dhe raporti shpjegues Seria e traktateve europiane - nr. 126. Teksti i rishikuar në përputhje me dispozitat Protokolleve nr. 1 (STE nr. 151) dhe nr.2 - STE nr. 152), që kanë hyrë në fuqi më 1 mars 2002
4. Konventa europiane për të drejtat e njeriut, Korrik, 2010
5. Konventa kundër torturës dhe trajtimeve dhe dënimeve të tjera mizore çnjerëore ose poshtëruese, Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984
6. Kushtetuta e Rep. së Shqipërisë
7. Kushtetuta e Republikës së Kosovës
8. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut
9. Ligji mbi shtetet; Gerhard von Glahn, James Larry Taulbee, 2015
10. Ligji ndërkombëtar; J. Dougard, 2006
11. Ligji nr 1393 ‘‘Aktit të Ratifikimit të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale’’, dt 11 dhjetorë 2000
12. Ligji nr 1842; 26 qershorë 2002.
13. Ligji për sigurin ndërkombëtare; John Norton Moore, Robert F. Turner, 2005
14. Prokurori kundër Blaškiç, TNVJ- Çështja nr:
15. Prokuroria kundër Akasey; Tribunali I Ruandës, Çështja nr -96-4-T, <https://www.hrw.org/reports/2004/ij/ictr/4.htm>